

ENHANCEMENTS IN THE QUALITY OF EDUCATION
AND TRAINING IN SOUTH EASTERN EUROPE



EDUKIM PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM
- SI TË PËRMIRËSOJMË PERFORMANCËN
NDAJ MJEDISIT NË SHKOLLË

UDHËZUES PRAKTIK PËR MËSUES

Botues:

Nisma për Reformën e Arsimit të Evropës Juglindore

Dečanska 8a, 11000 Beograd, Serbi

www.erisee.org, office@erisee.org

Autor:

Ermelinda Mahmutaj

Përpunoi:

Tina Šarić

Për botuesin

Tina Šarić

Publikuar

Maj, 2024

Përkthimi

Idioma

Deligradska 14, Beograd, Serbi,

idioma.rs, office@idioma.rs

ISBN: ISBN-978-86-82886-02-0

Tabela e përmbajtjes

Parathënie	4
Hyrje	5
Zhvillimi i qëndrueshëm	6
Pikat kyçe historike të zhvillimit të qëndrueshëm	7
Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm - 17 objektiva për transformimin e botës sonë	9
Rruga e qëndrueshme evropiane deri në vitin 2030	10
Parimet kyçe të qëndrueshmërisë.....	12
Qëndrueshmëria dhe arsimi: Konceptet dhe strategjitë	13
Edukimi për Zhvillim të qëndrueshëm.....	13
Përse duhet të zbatohet edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm?	15
Si duhet të zbatohet edukimi mbi zhvillimin e qëndrueshëm?	16
Shkollat – njësitë e pazëvendësueshme të kompetencës në fushën e mjedisit	18
Shkollat si modele të qëndrueshmërisë - hapat drejt eko-shkollës	19
Kompetencat e ligjëruesit në edukim për Zhvillim të qëndrueshëm	20
Zhvillimi dhe aktivitetet/strategjitë e EZHQ për shkollën tuaj	22
Integrioni qasjet e ekonomisë cirkulare në nismën tuaj për shkollat e gjelbra	35
Uditimi i brendshëm i shkollës mbi ngritjen e një shoqërie të qëndrueshme	37
Përfundimi:	39
Literaturë	40
Aneksë 1: Loja “Të vjelësh apo të mos vjelësh”	44
Aneksë 2: Formulari i eko-hartës	46
Aneksë 3: Lista kontrolluese për ngritjen e një shoqërie të qëndrueshme.	48

Parathënie

Udhëzuesi praktik “Edukim për zhvillim të qëndrueshëm - si të përmirësojmë performancën ndaj mjedisit në shkollë” është konceptuar si një mjet dhe strukturë e dobishme për të gjithë mësues në arsimin fillor dhe të mesëm, të tipit formal, joformal dhe informal, si dhe për shërbimet e tjera arsimore të lidhura me punën e shkollave (vlerësues të jashtëm, shërbimet profesionale të pedagogëve, psikologëve dhe të tjerë), me qëllim që të mundësohet integrimi i komponentëve dhe vlerave të edukimit për një zhvillim të qëndrueshëm të shkollave, pavarësisht nga niveli fillestar i shkollës, lokacioni i shkollës ose mjedisi socio-ekonomik dhe kulturor.

Ky udhëzues ofron një sërë aktiviteteve praktike për një qasje komplekse, dinamike, ndërsektoriale dhe ambicioze “në nivel shkollë”, për përmirësim të performancës dhe gjurmës ekologjike të shkollave me qëllim përfundimtar për të përmirësuar të mësuarit, sjelljen dhe mirëqenien e nxënësve dhe për të formuar qytetarë të përgjegjshëm për një të ardhme të qëndrueshme.

Përmbajtja bazohet mbi lojën edukative nga fusha e mjedisit „Të vjelësh apo të mos vjelësh“ për etikën e gjelbër që trajton zgjidhjen e konflikteve tona të brendshme midis konsumerizmit dhe futurizmit të qëndrueshëm. Loja është plotësisht në përputhje me parimet e përmbajtura në çdo kapitull të këtij Udhëzuesi dhe ofron tema të ndryshme për të menduar, me një qasje praktike.

Udhëzuesi e orienton lexuesin nëpër pika të ndryshme të vendosjeve globale për qëndrueshmëri dhe Agjendë ambicioze për zhvillim të qëndrueshëm deri në vitin 2030 bashkë me 17 objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm, duke treguar dhe theksuar rregullisht rolin e pazëvendësueshëm të shkollave në arsim cilësor, arsim për zhvillim të qëndrueshëm dhe kompetenca ekologjike. Udhëzuesi nuk e lehtëson edukimin për zhvillim të qëndrueshëm, por e bën atë realist dhe më të zbatueshëm.

Përmes këtij Udhëzuesi, ligjëruesi konsiderohet nxitës i tërë praktikës për përmirësim të performancës ndaj mjedisit në shkolla dhe këshillohet në mënyrë të saktë mbi kompetencat e nevojshme në edukimin për zhvillim të qëndrueshëm. Edhe pse Udhëzuesi i jep ligjëruesit informacione se çfarë duhet të bëjë, si dhe arsytimin e rëndësisë së aktiviteteve të caktuara, ai më tepër elaboron aspektet praktike, sidomos duke pasur parasysh rrethanat reale dhe përbërjen e çdo shkolle. Hapat dhe shënimet e plotësojnë kornizën e zhvillimit të strategjisë së shkollës për arsim të qëndrueshëm nga fusha e mjedisit, dhe akoma më e rëndësishme por që shpeshherë merret si diçka e mirëqenë, verifikojnë rregullisht se si kurikula mjedisore kontribuon për një shoqëri të qëndrueshme.

Me pak fjalë, shpresojmë të frymëzojmë sa më shumë nga ju përmes këtij Udhëzuesi dhe të nxisim efektin domino të shkollave të gjelbra në Ballkanin Perëndimor dhe Republikën e Moldavisë. Mirëpresim pyetjet dhe feedback nga ana juaj në lidhje me udhëzuesin dhe do të mbështesim me kënaqësi nismat tuaja për shkolla të gjelbra! Ju urojmë shumë suksese!

Hyrje

A keni luajtur ndonjëherë lojën “Të vjelësh apo të mos vjelësh”? Bëhet fjalë për pyetje pa fund të cilat i bëjnë vetes pikërisht në momentin kur shohim një lule të bukur dhe kemi dëshirë ta vjelim nga toka dhe ta bëjmë tonin. Loja i referohet etikës së gjelbër dhe qëllimi i saj përfundimtar është që të kuptojmë vlerën e veprimeve tona. A ia vlen apo jo? Ku na çon kjo, si do të na kthehet, çfarë do të humbasim, duke menduar vazhdimisht për këtë lule?

Si qenie njerëzore, lojën mund ta lidhim shumë thjeshtë dhe ta zbatojmë në vendimet e përditshme dhe projektet e ardhshme të mirëqenies, por së pari duhet të mësojmë më shumë për këtë. Nëse ndalemi për një moment dhe kujtojmë historinë tonë, kur e bëme të famshme këtë lojë?

Industrializimi dhe urbanizimi masiv gjatë viteve 60 dhe 70 shkaktuan mobilizimin e njerëzve me qëllim të mbrojtjes së mjedisit. Nga ai moment ka kaluar gjysëm shekulli përpjekjesh për të zgjidhur çështjen e kontaminimit të ujit, ajrit dhe tokës, të shkaktuar nga zhvillimi i parregulluar ekonomik, njëkohësisht duke ngritur alarm për shkak të krizës së shëndetit publik. Dita e parë e Planetit të Tokës u organizua më 22 prill të vitit 1970 për të tërhequr vëmendjen e publikut te kërcënimet ndaj mjedisit, por bashkë me këtë lëvizje publike u miratuan ligje të rëndësishme për ruajtjen e mjedisit dhe kontrollin e ndotjes.

Deri në fund të viteve 1980, kjo lëvizje për mbrojtjen e mjedisit u fokusuar më shumë te çështjet globale të cilat mund të diskutoheshin në nivelin kombëtar, por që mund të zgjidheshin vetëm përmes diplomacisë ndërkombëtare. *Erdhi koha për koordinim global!* Detyrimet dhe koordinimi global të lidhura me aktivitetet e vazhdueshme lokale dhe disiplinat në fushën e mjedisit formuan atë që sot quhet “Lëvizja moderne për mbrojtjen e mjedisit”. Ajo nuk përfaqëson më vetëm shqetësimet e sektorit të prodhimit në lidhje me menaxhimin e burimeve natyrore për zhvillim të ardhshëm, por përfaqëson lëvizjen e konsumatorëve që kërkojnë mjedis të pastër, të sigurt dhe të bukur si pjesë e standardit më të lartë të jetesës. Ajo mbështetet nga ana e lëvizjes së angazhimit global për zhvillim të qëndrueshëm.

Zhvillimi i qëndrueshëm

Zhvillimi i qëndrueshëm është zhvillim që përmbush nevojat e së tashmes pa cenuar mundësitë e gjeneratave të ardhshme për të përmbushur nevojat e tyre. (Komisioni Botëror i Mjedisit dhe Zhvillimit, Raporti Brundtland, E Ardhmja Jonë e Përbashkët, 1987).


Termi u përkufizuar që në vitin 1987 dhe shërben si udhëheqës në këtë fushë sot e kësaj dite. Zhvillimi i qëndrueshëm nuk është një gjendje e pandryshueshme e harmonisë, por është një proces ndryshimesh ku shfrytëzimi i resurseve, drejtimi i investimeve, orientimi i zhvillimit teknologjik dhe ndryshimet institucionale harmonizohen me nevojat aktuale dhe ato të ardhshme. Ky proces nuk është i thjeshtë dhe është e domosdoshme që të bëhen disa zgjedhje të dhimbshme, duke pasur parasysh që mbijetesa e shoqërive tona dhe të planetit tonë të përbashkët varet nga bota më e qëndrueshme.

Për të realizuar këtë progres, është me rëndësi thelbësore që të harmonizohen tre elemente kryesore në vijim: Rritja ekonomike, përfshirja sociale dhe mbrojtja e mjedisit. Këto elemente janë të ndërlidhura dhe kanë rëndësi vendimtare për mirëqenien e individëve dhe shoqërive (fig. 1).

Figure 1. Three Visual Representations of Sustainable Development: Pillars, Circles, Interlocking Circles

A. Pillars

The three pillars of sustainable development



http://www.vda.de/en/service/jahresbericht/aut02002/auto+umwelt/u_3.html

B. Concentric circles



<http://www.sustainablecampus.cornell.edu/sustainability-intro.htm>

C. Overlapping Circles



The three pillars of sustainable development, from left to right, the theory, the reality and the change needed to better balance the model

<http://www.iucn.org/programme/>

Figura 1: Tri pamje vizuale të zhvillimit të qëndrueshëm (IUCN, 2006): shtyllat, rrrathët dhe rrrathët e lidhur (qasje e folezimit): Pamje skematike me elipsa të folezuara thekson hierarkinë e dimensioneve, duke vendosur mjedisin si bazë për dy të tjerat.

Pikat kyçe historike të zhvillimit të qëndrueshëm

Janë të shumta momentet që hyjnë në historinë e vendosmërisë globale për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Po theksojmë ato që mbahen mend më shumë dhe përbëjnë pika kthimi dhe/ose arritje të rëndësishme mbi të cilat janë ndërtuar planet dhe qëllimet e ardhshme për një planet të qëndrueshëm:

	<p>1972 – Konferenca e OKB-së për mjedisin njerëzor</p> <ul style="list-style-type: none"> Vendosja në plan të parë të lidhjes midis çështjeve mjedisore, ekonomike dhe shoqërore për herë të parë në këtë nivel, gjë që ka nxitur krijimin e Programit të OKB-së për mbrojtjen e mjedisit. Vënia e theksit të çështjet mjedisore shënon një hap të rëndësishëm dhe të përhershëm në bisedat e pasluftës mbi menaxhimin ndërkombëtar.
	<p>1987 – „Raporti Brundtland” përkufizon zhvillimin e qëndrueshëm</p> <ul style="list-style-type: none"> Komisioni Botëror i Mjedisit dhe Zhvillimit (WCED) publikoi raportin e tyre <i>E Ardhmja Jonë e Përbashkët</i>, të njohur si <i>Raporti Brundtland</i> Ndër elementët e ndryshëm kyçë gjendet përkufizimi i zhvillimit të qëndrueshëm që vazhdon të orientojë punën në këtë fushë sot e kësaj dite.
	<p>1988 - U themelua paneli ndërqeveritar për ndryshimet klimatike</p> <ul style="list-style-type: none"> Interfejsi i ri i shkencës dhe politikës që mbledh shkencëtarët e klimës dhe zyrtarët qeveritarë. Raportet e vlerësimit ofrojnë informacionet kyçe mbi gjendjen e zbutjes së ndryshimeve klimatike, adaptimin dhe vulnerabilitetin ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe për shkencën kryesore të ndryshimit klimatike.
	<p>1992 – Samiti për Tokën në Rio e ka fokusuar vëmendjen te zhvillimi i qëndrueshëm</p> <ul style="list-style-type: none"> Shënon tentativën e parë ndërkombëtare të hartimit të planeve të veprimit dhe strategjive për lëvizje drejt një forme më të qëndrueshme të zhvillimit - miratimi i <i>Agjendës 21</i>. U paraqitën Konventa Kuadër e OKB-së për ndryshimet klimatike (UNFCCC), Konventa e OKB-së mbi diversitetin biologjik dhe Konventa e OKB-së për Luftimin e Shkretëtirëzimit
	<p>1997 – Palët e UNFCCC kanë miratuar Protokollin e Kiotos</p> <ul style="list-style-type: none"> Detyron vetëm ekonomi të zhvilluara dhe vendos qëllimet për zvogëlimin e emetimeve Veçanërisht prezantohet koncepti i “përgjegjësisë dhe aftësisë së përbashkët por të diferencuar” për zgjidhjen e barrës së ndryshimeve klimatike
	<p>2000 - Shtetet anëtare të OKB-së kanë miratuar Deklaratën e Mijëvjeçarit</p> <ul style="list-style-type: none"> U vendos një agjendë e cila trajton luftimin e urisë, degradimin e mjedisit, varfërinë, deri te përmirësimi i qasjes në resurset kryesore siç është uji. Tetë objektiva zhvillimore të mijëvjeçarit (OZHM) nga Deklarata kanë udhëhequr politikën zhvillimore ndërkombëtare për 15 vjet.



2002 - Samiti Botëror mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm

- Liderët botërorë dhe zyrtarët qeveritarë takohen për të miratuar deklaratën politike dhe planin shoqëruar të veprimit për zgjidhjen e çështjeve që lëvizin nga biodiversiteti dhe energjia e deri tek bujqësia, duke nxitur shumë çështje që kanë të bëjnë me rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) dhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare, siç është Protokollin e Kiotos.



2012 – Konferenca Rio+20

- E njohur si Konferenca e OKB-së mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm.
- U miratua deklarata për “Të Ardhmen që duam”, duke përgatitur bazën për procesin e hartimit të agjendës zhvillimore për periudhën pas vitit 2015 kur të kalojë afati për arritjen e Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit.



2015 - Miratimi i Marrëveshjes së Parisit për ndryshimet klimatike

- Marrëveshja e parë universale për klimën: *Mbajtja e temperaturës nën 2 dhe mbajtja e rritjes së temperaturës deri në 1,5.* Vendet e zhvilluara marrin udhëheqje, vendet në zhvillim marrin para për uljen e emetimeve. *Pikë kthimi historik që përfaqëson fillimin e rrugëtimit.*
- Nuk i lumturon të gjithë; por është një hap i madh për njerëzimin.



2015 – Miratimi i Agjendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030

- Miratimi i Agjendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030 me 17 objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm dhe 169 detyra përbën vendosmëri unanime për çrrënjosjen e varfërisë, luftimin e pabarazive dhe të padrejtësisë dhe zgjidhjen e çështjeve të ndryshimeve klimatike.
- Kjo vendosmëri i dha një hov globale punës ndërkombëtare, kombëtare dhe nënkombëtare nga pikëpamja e qëndrueshmërisë.



2022 – Asambleja e OKB-së për mjedisin ka filluar negociatën mbi Marrëveshjen për Parandalimin e Ndotjes me Plastikë

- U miratuan vendimet për negociimin e Marrëveshjes për Parandalimin e Ndotjes me Plastikë, për vendosjen e një paneli shkencor-politik për kimikatet dhe mbeturinat - dhe shumë më shumë se kaq, si pasojë e shqetësimit për shkak të “krizës së trefishtë planetare” të ndryshimeve klimatike, humbjes së natyrës dhe biodiversitetit, dhe ndotjes.

Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm - 17 objektiva për transformimin e botës sonë

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) janë pjesë përbërëse e Agjendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030. Objektivat synojnë përmirësimin e jetesës së *të gjithë njerëzve gjithandej* dhe përbëjnë një vendosmëri globale, thirrje për veprim të të gjitha vendeve - pavarësisht nga klasifikimi i tyre sipas nivelit të të ardhurave si vende të varfëra, të pasura ose të ndërmjetme - që të bëjnë një ekuilibër midis prosperitetit dhe mbrojtjes së planetit dhe të nisen drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme.

Përmes OZHQ-ve u identifikua fakti që çrrënjosja e varfërisë duhet të shkojë dorë për dorë me strategjitë me anë të të cilave ndërtohet rritja ekonomike dhe zgjidhen nevojat të ndryshme shoqërore, duke përfshirë arsimin, shëndetësinë, mbrojtjen sociale dhe mundësi punësimi, ndërsa njëkohësisht zgjidhen çështjet e ndryshimeve klimatike dhe të mbrojtjes së mjedisit. Tek shtatëmbëdhjetë objektiva që bazohen mbi suksesin e Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit dhe janë të ndërlidhura - *nënkuptohet që çelësi i suksesit të një objektiv shpesh herë do të përfshijë zgjidhjen e çështjeve që shpesh janë të lidhura me objektivat e tjera.*



Figura 2: Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm - 17 objektiva për transformimin e botës sonë

Shënim i rëndësishëm!

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) nuk janë të detyrueshëm nga ana ligjore, por pritet nga vendet që të marrin kontroll dhe rol udhëheqës mbi to, të vendosin korniza kombëtare për arritjen e objektivave dhe të harmonizohen kështu me vendosmëritë e tyre globale. Implementimi dhe suksesi do të mbështeten tek politikat e veta, planet dhe programet e zhvillimit të qëndrueshëm të vendeve. Për të ndjekur implementimin dhe nivelin e performancës

në arritjen e OZHQ-ve, janë përkufizuar detyra dhe tregues të qartë për secilin nga objektivat. Janë gjithsej 169 detyra nga të cilat 10 i referohen matjes së progresit për “Arsim cilësor” që përbën objektivin e 4-të të zhvillimit të qëndrueshëm.

Rruga e qëndrueshme evropiane deri në vitin 2030

Bashkimi Evropian ka luajtur rolin kyç në formimin e Agjendës globale për zhvillim të qëndrueshëm deri në vitin 2030 dhe mbetet i përkushtuar në zbatimin e saj. Komisioni prezantoi një program politik ambicioz për arritjen e qëllimeve të qëndrueshmërisë në BE por edhe më gjerë, që ka OZHQ-të në qendër të krijimit të politikave të aktiviteteve të brendshme dhe të jashtme në të gjithë sektorët.

Marrëveshja e Gjellbër Evropiane është një nga pakot e reja të politikave të transformimit të thellë, e nisur në vitin 2019. Qëllimi është vënia e BE-së në rrugën e transformimit të gjellbër, me qëllim përfundimtar të arritjes së neutralitetit klimatik deri në vitin 2050. Pakoja përfshin 12 nisma për zgjidhjen dhe arritjen e 12 OZHQ-ve që përfshijnë klimën, mjedisin, energjinë, transportin, industrinë, bujqësinë dhe financa të qëndrueshme - dhe të gjitha janë të ndërlidhura fort.

Cilat nisma përfshin Marrëveshja e Gjellbër?

Spremi për 55%	Evropski zakon o klimi	Strategjia EU o prilagođavanju klimatskim promenama	Strategjia EU o biodiverzitetu za 2030. godinu	Baterije i otpadne baterije	Čista, pristupačna i sigurna energija
Kako će EU klimatske ciljeve pretvoriti u zakon.	EU i njene države članice su se obavezale da će smanjiti neto emisije gasova sa efektom staklene bašte u EU za najmanje 55% do 2030. godine, u poređenju sa nivoima iz 1990.	Daje pregled dugoročne vizije da EU postane društvo otporno na klimatske promene koje je u potpunosti prilagođeno neizbežnim uticajima klimatskih promena do 2050. godine.	Cilj je da pruži pomoć oporavku biodiverziteta Evrope do 2030. godine.	Strategija usmerena ka održivom, cirkularnom, evropskom lancu snabdevanja baterijama	Pošto 75% emisija gasova sa efektom staklene bašte u EU potiče od upotrebe i proizvodnje energije, dekarbonizacija energetskog sektora je ključni korak ka klimatski neutralnoj EU.
Strategjia „od polja do stola“	Strategjia održivosti EU u oblasti hemikalija	Akcionni plan za cirkularnu ekonomiju	Pravedna tranzicija	Evropska industrijska strategija	Strategjia za šume i krčenje šuma za 2030. godinu
Da pomogne EU da postigne klimatsku neutralnost do 2050. godine, pomeranjem trenutnog prehranbenog sistema EU ka održivom modelu.	Dugoročna vizija za politiku EU o hemikalijama kojom EU i države članice žele da: bolje zaštite zdravlje ljudi, ojačaju konkurentnost industrije, podrže netoksičnu životnu sredinu.	Razdvajanje ekonomskog rasta od korišćenja resursa i prelazak na cirkularne sisteme u proizvodnji i potrošnji je ključno za postizanje klimatske neutralnosti EU do 2050. godine. Akcionni plan za cirkularnu ekonomiju predviđa preko 30 akcionih tačaka na kreiranju održivih proizvoda, cirkularnosti u proizvodnim procesima i osnaživanju potrošača i javnih kupaca.	Mehanizam pravedne tranzicije pruža finansijsku i tehničku podršku regionima koji su najviše pogođeni prelaskom na niskougljeničnu privredu. Predložen je skup inicijativa za održivo finansiranje: investicioni planovi, taksonomija zelenih investicija, pravilnici o zelenim obveznicama	koja treba da podrži industriju u njenoj ulozi katalizatora i pokretača promena, inovacije i rasta.	Nadovezuje se na strategiju EU o biodiverzitetu i čini ključni deo napora za smanjenje emisije gasova sa efektom staklene bašte za najmanje 55% do 2030. godine.

Figura 3: Nismat e marra përsipër nga Marrëveshja e Gjellbër të BE-së

Ambiciet e BE-së për tranzicion të gjellbër për të arritur objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm të Agjendës së Gjellbër deri në vitin 2030 duke e bërë kështu Evropën kontinent të parë me neutralitet klimatik deri në vitin 2050, përhapen edhe në Ballkanin Perëndimor (BP). Si fqinjë dhe kandidatë që synojnë anëtarësi në BE, zgjidhja e çështjes së qëndrueshmërisë në vendet e Ballkanit Perëndimor përbën prioritet për BE-në. Agjenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor (AGJBP), në përputhje me Marrëveshjen e Gjellbër të BE-së dhe Planin Ekonomik dhe të

Investimeve për BP, shtron rrugën e transformimit drejt ekonomive të gjelbra, cirkulare dhe rezistente me neutralitet klimatik.

Liderët rajonalë të Bankës Botërore kanë miratuar AGJBP në vitin 2020 në Samitin e Sofjes dhe u detyruan që të reflektojnë qëllimet e BE-së për arritjen e neutralitetit klimatik dhe të qëndrueshmërisë. Kjo është një strategji e re e rritjes për rajonin, me të cilën mundësohet transferimi nga modeli ekonomik tradicional tek ekonomia e qëndrueshme. Qëllimi i saj është tranzicioni i gjelbër i BP dhe ofrimi i ndihmës për vendet që të harmonizojnë rregullat e tyre mjedisore me Acquis-in e BE-së.

AGJBP bazohet mbi pesë shtylla kryesore në lidhje me 12 OZHQ që janë në fokusin e nismave në kuadër të Marrëveshjes së Gjelbër të BE-së: 1) Mbrojtja e klimës dhe dekarbonizimi me qëllim të uljes së emetimit të gazrave me efekt serre dhe harmonizimit me neutralitetin karbonik të BE-së deri në vitin 2050; 2) Lëvizja drejt ekonomisë cirkulare; 3) Zvogëlimi i ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës; 4) Përmirësimi i metodave të qëndrueshme të prodhimit të ushqimit; dhe 5) Mbrojtja e biodiversitetit dhe të ekosistemeve.

Qeveritë kombëtare të BP-së, në bashkëpunim me Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (KBR) kanë përgatitur Strategjinë e Evropës Juglindore deri në vitin 2030 si dhe Planin e Veprimit (nga viti 2021 deri në vitin 2030) për implementimin e Agjendës së Gjelbër, ku përkufizohen qëllimet dhe objektivat e synuara për çdo vend. Këto dokumente përbëjnë kornizën kryesore të detyrave që kanë marrë përsipër vendet e Ballkanit Perëndimor në lidhje me reformat e domosdoshme për zgjidhen e problemeve të tyre thelbësore të sfidave klimatike dhe sfidave nga fusha e mjedisit.

BE mbështet financiarisht implementimin e Agjendës së Gjelbër ambicioze përmes Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit (IAPA). Korniza e investimit për Ballkanin Perëndimor, Fondi Evropian për Zhvillim të Qëndrueshëm plus (FEZHQ+) dhe instrumentet e tjera janë mekanizmat kryesorë të implementimit në këtë pikëpamje.

Parimet kyçe të qëndrueshmërisë

Qëndrueshmëria dhe zhvillimi i qëndrueshëm janë dy terma që përdoren shpesh për të shënuar të njëjtën gjë, edhe pse UNESCO i dallon: *“Qëndrueshmëria shpesh herë konsiderohet si qëllim afatgjatë (botë e qëndrueshme), ndërsa zhvillimi i qëndrueshëm u referohet proceseve dhe rrugëve të ndryshme për të arritur këtë qëllim”*. Fjalori i Oksfordit i gjuhës angleze përkufizon qëndrueshmërinë si: *“Veti e të qenit i qëndrueshëm nga pikëpamja e mjedisit; shkalla në të cilën një proces ose kompani është në gjendje të mbajë veten ose të vazhdojë punën duke shmangur shterjen afatgjatë të burimeve natyrore”*.

Në këtë Udhëzues miratojmë dallimin që bën UNESCO dhe sqarojmë në mënyrë të detajuar këto dy terma në mënyrë që të tregojmë aktivitetet që shoqëria jonë ndërmerr ose ka ndërmarrë me qëllim të harmonizimit me parimet e një shoqërie të qëndrueshme. „Kujdesi për tokën“ në strategjinë e tij për jetesë të qëndrueshme nga viti 1991 propozon 9 parime për një shoqëri të qëndrueshme. Këto parime janë relevante sot e kësaj dite dhe përfshijnë vendosmëri të përbashkëta mbi të cilat bazohen OZHQ-të: Njerëzit, planeti, prosperiteti, paqja dhe partneritet.

Do të kthehemi te këto 9 parime në pjesën e fundit të Udhëzuesit në mënyrë që t’u referohemi dhe t’i shfrytëzojmë për t’ju ndihmuar si mësues që të ndiqni dhe të kontrolloni se si aktivitetet tuaja arsimore shkollore për zhvillim të qëndrueshëm e formojnë shoqërinë jashtë oborrit të shkollës.

Qëndrueshmëria dhe arsimit: Konceptet dhe strategjitë

Si të luajmë lojën e të menduarit “Të vjelësh apo të mos vjelësh” dhe si të marrim vendimin e duhur? Përveç se duhet të njohim mirë nevojat tona dhe realitetin, gjithashtu është e nevojshme të njohim dhe rolin e asaj luleje dhe përse është apo nuk është e rëndësishme, çfarë qëllimi ka dhe çfarë lidhjeje ka me ne.

Për të marrë këto njohuri dhe për t’u siguruar që ajo të transferohet nga brezi në brez, strategjitë e qëndrueshmërisë janë me rëndësi kyçe sepse ato e identifikojnë arsimin si një komponent të rëndësishëm dhe si një mjet që ka lindur dhe konsoliduar Edukimin për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Edukimi për Zhvillim të qëndrueshëm

Edukimi për Zhvillim të qëndrueshëm (EZHQ) përfaqëson një lloj edukimi që tejkalon njohuritë dhe vetëdijen mbi faktet në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm. Zhvillon aftësitë e jetës dhe kompetencat; qëndrimet dhe vlerat e nevojshme për vendimmarrje dhe pjesëmarrje në aktivitetet praktike që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm.

Dekada e Edukimit për Zhvillim të Qëndrueshëm të OKB-së (DEZHQ, 2005) ka theksuar shprehimisht rolin e edukimit në zhvillim të qëndrueshëm. Qëllimi i saj ishte integrimi i parimeve dhe praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm në të gjitha aspektet e arsimit dhe të mësuarit, të nxisë ndryshimet e njohurive, vlerave dhe qëndrimeve me vizionin për të mundësuar një shoqëri më të qëndrueshme dhe të drejtë për të gjithë. Dekada përfundoi në vitin 2014 duke vendosur një bazë të fortë për përmirësimin e zhvillimit të qëndrueshëm përmes arsimit dhe të mësuarit. Sot OZHQ kanë përparuar dhe përfshijnë një objektivë direkte për këto qëllime: 4.7 – *Deri në vitin 2030 të sigurohet që të gjithë nxënësit të marrin njohuritë dhe aftësitë e duhura për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, duke përfshirë, ndër të tjerat, përmes edukimit për zhvillim të qëndrueshëm dhe stil të qëndrueshëm të jetesës, të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, avancimin e kulturës së paqes dhe të jodhunës, qytetarinë globale dhe vlerësimin e diversitetit kulturor dhe të kontributit të kulturës në zhvillimin e qëndrueshëm.*

Për të realizuar dhe mbështetur aktivitetet e EZHQ në të gjitha nivele, në të gjitha fushat e arsimit dhe në çdo sektor të zhvillimit të qëndrueshëm, programet dhe politikat janë përmirësuar me [#ESDfor2030](#) për një integrim të plotë të EZHQ dhe të 17 OZHQ në politika, mjedise mësimore, ndërtimin e kapaciteteve të ligjëruesve, fuqizimin dhe mobilizimin e të rinjve dhe të aktiviteve në nivelin lokal.

Duke marrë parasysh faktin që ka mbetur pak kohë për arritjen e OZHQ-ve, është me rëndësi thelbësore që EZHQ të përshejtohet në këtë dekadë në mënyrë që të arrihen qëllimet.

Pra, si mund të bëheni proaktiv dhe të kontribuoni drejtpërdrejtë në objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm si mësues?

Hapat e thjeshtë për përmirësim:

- *Informohuni dhe jini të informuar mbi qëndrueshmërinë!* Kjo do të zgjerojë njohurinë tuaj, do t'ju ndihmojë që të zhvilloni mendime të themeluara dhe të përfshihen në biseda kuptimplota; të kuptoni sfidat dhe mundësitë në drejtim të qëndrueshmërisë për të përmirësuar aktivitetet tuaja dhe për të frymëzuar shoqërinë që të bëjë të njëjtën gjë. Pra, përkufizoni se për çka doni të informoheni dhe zgjidhni burimet tuaja të informimit në një mori publikimesh, lajmesh, diskutimesh të ekspertëve, nismash të komunitetit etj. dhe përditësojini herë pas here. Si fillim mund të gjeni disa materiale të besueshme nga burimet në vijim, dhe gjithmonë mund të vazhdoni vetë me kërkimin: The Guardian <https://www.theguardian.com/uk/environment>; Research gate: <https://www.researchgate.net/> për marrjen e njohurive shkencore; UNESCO webpage: <https://www.unesco.org/en>; publikimet e porositura përmes OKB-së: <https://sdgs.un.org/publications>; The Journal of Environmental Education: <https://www.tandfonline.com/action/showOpenAccess?journalCode=vjee20>; the green teacher magazine <https://greenteacher.com/magazine/about-us/>; resurset edukative përmes faqes si internetit të WWF: <https://www.worldwildlife.org/teaching-resources>; resurset edukative dhe lajmet përmes organizatës rinore për mbrojtjen e mjedisit, YEE është një nga to: <https://yeenet.eu/publications/> si dhe organizatat tuaja kombëtare mediatike dhe organizatat për mbrojtjen e mjedisit.
- *Integroni EZHQ në shkollën tuaj dhe zhvilloni kurrikulën e EZHQ-së!* Me këtë hap do të përmirësoni performancën e shkollës suaj ndaj mjedisit dhe do të zbatoni qëndrueshmëri. Hapat gjithëpërfshirës dhe praktik në lidhje me sa më lart do të paraqiten në këtë Udhëzues.
- *Merrni pjesë në nismën e vendit tuaj për EZHQ për vitin 2030!* Mënyra konkrete dhe më e fokusuar formale për nisjen e pjesëmarrjes aktive është përmes nismës së vendit tuaj për EZHQ për vitin 2030. Kjo nismë udhëhiqet nga ministria juaj kompetente për arsim në bashkërendim me ministritë e tjera të linjës siç është ministria e mbrojtjes së mjedisit. Konsiderohet si nismë ombrellë që zakonisht përfshin sa më shumë aktivitete aktuale në lidhje me EZHQ në vend.
- *Rrjetëzohuni!* Bashkëpunoni me shkollat e tjera në qytetin ose vendin tuaj; bashkëpunoni me komunitetin tuaj dhe palët e interesuara lokale dhe kombëtare. Rrjetëzimi është gjithmonë situatë fituese në të cilën merrni dhe jepni në kushte të njëjta dhe përparoni gjithmonë. Ndoshta do të doni të shqyrtoni “Rrjetet partnere” të themeluara nga UNESCO si komunitet global i praktikës, me qëllim të përforcimit të sinergjisë dhe të përshejtimit të aktiviteteve të mëtejshme të palëve të tjera të interesuara të EZHQ-së.
- *Kurrë mos pushoni së zhvilluari kapacitetet për Edukim për Zhvillim të Qëndrueshëm!* Trajtohuni në mënyrë sistematike duke shfrytëzuar çdo rast që është në përputhje me objektivat tuaja, nivelin e njohurive dhe aftësive.
- *Zbatoni EZHQ me të gjithë, gjithmonë dhe gjithandej!* Kjo është një këshillë morale dhe etike në mënyrë që të kuptojmë të gjithë se kurrë nuk duhet të ndalemi me edukimin për Zhvillim të qëndrueshëm, pavarësisht nëse jemi në mjedis shkolle apo jo. Duhet të integrojmë dhe të zbatojmë vazhdimisht parimet e EZHQ-së në jetën tonë të përditshme dhe të nxisim veten për t'u bërë model qëndrueshmërie për familjen tonë, miqtë, fqinjët, personat që takojmë rastësisht etj. duke ndarë me ta dobinë reale të kësaj.

Përse duhet të zbatohet edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm?

Jemi të vetëdijshëm që po jetojmë në një kohë shumë dinamike me transformime të mëdha në bazë të të cilave është qëndrueshmëria. Megjithatë, si ta dimë ne si individë, komunitete dhe shoqëri se qëndrueshmërinë e kemi si qëllim, në fokusin e aktiviteteve tona? Si kontribuojmë në arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme? Si mund të sigurohemi që jemi pjesë e këtij misioni, si partneritet global i komuniteteve, të gjithë bashkë? EZHQ është një komponent dhe vegël e cila, nëse integrohet me sukses në të gjitha nivelet e arsimit, do të na udhëheqë që t'u përgjigjemi këtyre pyetjeve si dhe do të na ndihmojë që të kuptojmë nivelin tonë të qëndrueshmërisë dhe ku duhet të fokusojmë aktivitetet tona.

Përse duhet të zbatohet edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm? Sepse është pjesë përbërëse e arsimit cilësor dhe karakterizohet nga sa më poshtë:

- Është proces i të nxënësve gjatë gjithë jetës që përmirëson dimensionet kognitive, shoqërore, emocionale dhe biheviorale të të nxënësve.
- Aftëson nxënësit që të marrin vendime të themeluara dhe të ndërmarrin aktivitete të përgjegjshme për integritetin e mjedisit, qëndrueshmërinë ekonomike dhe shoqëri të drejtë.
- Ky proces u identifikua si nxitës i të gjitha qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm që arrin qëllimin e vet përmes transformimit të shoqërisë.
- Fuqizon njerëzit e të gjitha gjinive, moshave, gjeneratave aktuale dhe të ardhshme, duke respektuar diversitetin kulturor.
- Përgatit njerëzit e të gjitha shtresave shoqërore që të planifikojnë, që të luftojnë dhe të gjejnë zgjidhje për problemet që cenojnë qëndrueshmërinë e planetit tonë.

Theksi i veçantë i EZHQ-së te kompetencat që i referohen empatisë, solidaritetit dhe ndërmarrjes së aktiviteteve mund të:

- 1) Ndihmojë në përmirësimin e OZHQ 4 në procesin e ndërtimit të së ardhmes në të cilën arsimit nuk kontribuon vetëm në suksesin e individëve, por edhe në mbijetesën kolektive dhe prosperitetin e komunitetit global;
- 2) Ndihmojë agjendën globale të edukimit që të lëvizë fokusin e bazuar vetëm tek qasja dhe cilësia që kryesisht matet përmes rezultateve të të mësuarit, drejt një theksi më të veçantë te përmbajtja e të mësuarit dhe kontributi i tij në qëndrueshmërinë e njerëzve dhe të planetit. Në këtë mënyrë EZHQ e lidh OZHQ 4 me të gjitha objektivat e tjera të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ).

Ju si mësues, keni mundësi unike për të formuar nxënësit tuaj që të veprojnë në përputhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ) që nga moshën më të hershme deri tek moshën e rritur, gjë që do t'i ndihmojë që të bëhen qytetarë të informuar, të vetëdijshëm dhe proaktiv të cilët do të jenë të aftë të reagojnë ndaj çështjeve kryesore të përkufizuara nga objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ).

Si duhet të zbatohet edukimi mbi zhvillimin e qëndrueshëm?

Edukimi luan rolin kryesor në mundësimin e pjesëmarrjes së të rinjve në zgjidhjen e sfidave globale. Kjo nuk i referohet vetëm arsimit formal, por edhe atij joformal dhe informal, sepse dy të fundit gjithashtu ndikojnë në formimin e qëndrimeve dhe vlerave tek të rinjtë. Së bashku me shkollat formale, arsimi joformal dhe informal luajnë rol të rëndësishëm në formimin e shoqërisë (Nyoni, 2009).

Qëndrueshmëria është një sfidë globale dhe përgjegjësi e gjeneratave të tashme dhe të ardhshme. Nuk ekziston një didaktikë të saktë apo të pasaktë mbi mënyrën se si zbatohet edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm, por ekziston konsensus i gjerë që ky edukim duhet të fusë pjesëmarrjen aktive dhe angazhimin kuptimplotë të nxënësve në mjedisin mësimor. Disa elemente të mënyrës se si arrihet kjo janë në vijim:

- *Kombinoni arsimin formal me atë joformal dhe informal:* Kur edukojmë mbi zhvillimin e qëndrueshëm gjithmonë duhet të mendojmë për ndikimin global dhe të kemi parasysh që po formojmë shoqërinë dhe jo vetëm “nxënësin”. Është e rëndësishme të mbështesim aktivitetet joformale dhe informale të EZHQ-së sepse ato janë plotësimi thelbësor i arsimit formal, sidomos në edukimin e të rriturve.
- *Zhvilloni të menduarit kritik të nxënësve:* Ideja është që të nxitet mënyra kritike e të menduarit tek të rinjtë në kuadër të mëimit tradicional, përmes artikujve të gazetave, nëpër diskutime në grup, përmes të menduarit dhe dhënies së feedbackut etj.
- *Udhëhiqni nxënësin nëpër sistem, duke menduar nga perspektiva e sistemit:* Përdorni historitë nga jeta reale dhe situatat reale në shkollën tuaj për t’i nxitur nxënësit që të kuptojnë ndërthurjen e marrëdhënieve në ekosistemet biologjike dhe urbane, dhe të mos fokusohen te detajet e një pjese të caktuar; nxitini që të kuptojnë që zgjidhja e një problemi mund të çojë më vonë në probleme të reja më të mëdha ose në ndonjë vend tjetër të sistemit, nëse zgjidhjet nuk janë të ndërlidhura mirë.
- *Nxisni kreativitetin dhe inovacionin për skenarët e ardhshëm:* Mundësojuni nxënësve tuaj hapësirë që të krijojnë zgjidhjet e tyre për sfidat nga jeta dhe situatat reale në shkollë që keni diskutuar bashkë, dhe të prezantojnë këto zgjidhje përmes lojës së roleve, vizualizimit, krijimit të vizionit për të ardhmen.
- *Ndikoni te nxënësit që të zhvillojnë ndërgjegjësim për vetën e vet:* Siguroni instrumentet për nxënësit, si dhe udhëzimet e drejtpërdrejta dhe skenarët në të cilat secili prej tyre mund të mendojë për rolin e vet në komunitetin lokal, në shoqërinë globale, për vlerësimin dhe motivimin e mëtejshëm të aktiviteteve të tyre të qëndrueshme dhe për mënyrën se si t’ia dalin me ndjenjat dhe dëshirat e tyre.
- *Tregoni bashkëpunim:* Duke ftuar kolegët tuaj nga disiplina të ndryshme, duke marrë ligjërues të ftuar, duke marrë shembuj nga institucionet e ndryshme, duke integruar komunitetin në disiplinat mësimore, duke komunikuar dhe bashkëpunuar me media etj.



Shënim!

Ndoshta duket e dukshme, por kurrë nuk mund të theksohet mjaftueshëm se sa e rëndësishme është marrja e njohurive për EZHQ. Gjithmonë është e rëndësishme të ftojme të rinjtë që të lexojnë dhe të marrin periodikisht informacione të përditësuara. Pa informacionet përkatëse në kohën reale, zbatimi i EZHQ-së përfundon vetëm me qasje teorike dhe simultane. *Ju këshillojmë të praktikoni këtë!*

Shkollat – njësitë e pazëvendësueshme të kompetencës në fushën e mjedisit

Për një person me kompetenca mjedisore do të përdorim përkufizimin e UNESCO-s dhe të Shoqatës së Amerikës së Veriut për edukim për mjedisin: „*Dikush që tregon njohuri, prirje, kompetencë dhe sjellje për t'u përfshirë në mënyrë aktive - individuale ose grupore - në zgjidhjen e sfidave nga fusha e mjedisit*”. Si përkthehen këto fjalë kyçe - njohuri, dispozicion, kompetencë dhe sjellje - përmes prizmës së jetës reale?

Të mendojmë pak! Bota është angazhuar në formë të partneritetit global për të arritur rezultatet dhe objektivat e ZHQ deri në vitin 2030. Prapë se prapë, pavarësisht të gjitha nismave dhe progresit të arritur, ndryshimet në zonat urbane dhe natyrore, si për shembull deficitin ekologjik i burimeve natyrore, do të vazhdojë të ketë ndikime të konsiderueshme ekonomike dhe të tjera. Mosmarrëveshjet rreth mënyrës më të mirë të qasjes në këto çështje do të vazhdojnë të jenë sfiduese për sistemet shoqërore dhe politike. Vetëm publiku kompetent në fushën e mjedisit do të mund të kuptojë këto sfida dhe të gjejë zgjidhje të zbatueshme për to, bazuar në prova.

Citimi i Malkolm Iksit „*Arsimi është pasaportë për të ardhmen, sepse e nesërmja u takon atyre që përgatiten sot për të ardhmen*” – na kujton se sa të rëndësishme janë shkollat si vende ku mësohet dhe si bazë për ndërtimin e sjelljes së përgjegjshme ndaj mjedisit, si shprehje përfundimtare të kompetencës në fushën e mjedisit. Me zbatimin e EZHQ-së shkollat kalojnë nëpër përvoja, strategji dhe procese të rëndësishme për zhvillimin e kompetencës në fushën e mjedisit.


Siç thuhet në Strategjinë e EZHQ-së, institucionet e arsimit formal luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e kapaciteteve që nga moshën më të hershme, duke ofruar njohuri dhe duke ndikuar tek qëndrimet dhe sjelljet. Është e rëndësishme të sigurojmë marrjen e njohurive përkatëse mbi zhvillimin e qëndrueshëm për të gjithë nxënësit dhe studentët, si dhe të ndërgjegjësohen mbi ndikimin e vendimeve që nuk janë në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm. Shkollat luajnë rol të rëndësishëm në ndërtimin e një shoqërie kompetente dhe gjithmonë duhet të shohin rolin e tyre jo vetëm brenda oborrit të shkollës por edhe jashtë tij, duke përfshirë tërë shoqërinë. Ka qasje të ndryshme për sa i përket kontrollit të kontributit të shkollës në kompetencën e shoqërisë në fushën e mjedisit. Në këtë Udhëzues tregojmë disa prej tyre - Qasja në qëndrueshmëri në nivel shkollë dhe Auditimi i brendshëm i shkollës (me fletë kontrolluese që gjendet në anekset e këtij Udhëzuesi.)

Shkollat si modele të qëndrueshmërisë - hapat drejt eko-shkollës

Edhe pse përkufizohen dhe njihen si ambiente dinamike për edukimi për Zhvillim të qëndrueshëm, a nuk duhet shkollat të zbatojnë njëkohësisht njohuritë dhe teknologjitë në mënyrë që të zvogëlojnë gjurmën e tyre ekologjike, duke treguar kështu vlerat dhe sjelljet e tyre nga aspekti i mjedisit, përmes shembullit personal? E thënë më thjeshtë, a nuk duhet të bëjnë shkollat atë që thonë? Kjo integrohet plotësisht me “Qasjen e qëndrueshmërisë në nivelin e tërë shkollës”.

Qasja e EZHQ në nivelin e shkollës përfshin një filozofi holistike dhe pjesëmarrëse arsimore që synon përmirësimin e potencialit të mjedisit të shkollës në mënyrë që ai të funksionojë si një vend autentik dhe kuptimplotë i të nxënësit. Kemi një larmi të madhe të mënyrave të zbatimit të kësaj qasjeje në vende të ndryshme, si brenda vendeve, ashtu dhe anembanë botës.

Megjithatë, parimi i përbashkët udhëheqës është integrimi i tre drejtimeve të veprimit: 1) përfshirja e qëndrueshmërisë në kurikulën mësimore, 2) menaxhimi i mjedisit („gjelbërimi“) të shkollës dhe 3) vendosja e partneritetit të përhershëm me komunitetin e gjerë lokal me qëllim të zgjidhjes së problemeve të qëndrueshmërisë socio-ekologjike (Figura 4). Për këtë arsye, qasja në nivelin e shkollës kërkon përfshirje të të gjitha pjesëve të shkollës dhe të palëve të interesuara në shoqëri në mënyrë që nxënësit t’u ekspozohen problemeve reale të qëndrueshmërisë dhe t’u mundësohet demonstrimi praktik i sjelljes së qëndrueshme.



Qasja e qëndrueshmërisë në nivelin e gjithë shkollës zbatohet në mënyra të ndryshme që dallojnë nga vendi në vend, nga shkolla në shkollë.. Ideja kryesore është harmonizimi i qasjes në nivelin e gjithë shkollës me organizimin e shkollës dhe mënyrën e funksionimit të saj, dhe të mos imponohen ndryshimet nga jashtë, që mund të çojë në konflikte. Shkollat shpesh herë fillojnë me një aktivitet të qëndrueshmërisë, i cili i çon më tutje si puna e efektit domino. Me kalimin e kohës, shkolla miraton dhe zbaton praktika të ndryshme të qëndrueshme.

Figura 4: Tri fusha të qasjes në nivelin e shkollës

Kompetencat e ligjëruesit në edukim për Zhvillim të qëndrueshëm

EZHQ fton mësues të lëndëve të ndryshme që të bashkëpunojnë dhe të bashkojnë disa disiplina në një kurs të vetëm të mësimi me anë të metodave dhe instrumenteve të ndryshme. Kjo mënyrë do të ndihmojë nxënësit që të lidhin materialin mësimor, të mësojnë të mendojnë në mënyrë më kritike, të përmirësojnë aftësitë e tyre të zgjidhjes së problemeve dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. Kjo do të rrisë angazhimin e tyre dhe do t'i bëjë që të përjetojnë lëndët akademike në një mënyrë më realiste dhe më relevante, duke rritur aftësinë e tyre të zgjidhjes së problemeve përmes përdorimit kreativ të informacioneve nga njëra disiplinë për zgjidhjen e sfidave të disiplinës tjetër, dhe do t'i nxisë që të ushtrojnë disa qasje të ndryshme dhe të nxjerrin informacionet nga bazat e ndryshme të njohurive gjatë shqyrtimit të një teme të caktuar etj.

Është e qartë që mundësia e këtyre gjërave do të jetë sfidues për mësuesit por edhe për tërë sistemin arsimor. Si qasje kryesore kjo kërkon bashkëpunim të ngushtë midis mësuesve të lëndëve të ndryshme në mënyrë që të punojnë dhe mësojnë së bashku. Përveç kësaj, është e nevojshme që të kombinohet mësimi cilësor me tri karakteristika kryesore të EZHQ-së.

Karakteristikat kryesore të EZHQ-së	Kompetencat e ligjëruesve (Raporti UNECE 2012 „Të mësojmë për të ardhmen“.)
<ol style="list-style-type: none"> 1. Qasja holistike: Kërkon të menduarit interaktiv dhe praktikë; Përfshirje; ballafaqim me kompleksitete. 2. Imagjinimi i ndryshimeve, duke hulumtuar të ardhmet alternative, duke mësuar nga e kaluara dhe duke frymëzuar angazhim në të tashmen; 3. Arritja e transformimit, që shërben për ndryshimin e mënyrës se si mësojnë njerëzit, dhe të sistemeve që mbështesin të mësuarit. 	<ol style="list-style-type: none"> a. Të mësosh për të marrë njohuri i referohet mirëkuptimit të sfidave me të cilat ballafaqohet shoqëria në nivelin lokal dhe global, si dhe rolit potencial të ligjëruesve dhe nxënësve (ligjëruesi kupton...); b. Të mësosh për të ndër marrë aktivitete i referohet zhvillimit të aftësive praktike dhe kompetencave të veprimit në lidhje me edukimin për Zhvillim të qëndrueshëm (ligjëruesi mund të...); c. Të mësosh për të jetuar së bashku kontribuon në zhvillimin e partneriteteve dhe vlerësimin e varësisë së ndërsjellë, pluralizëm, mirëkuptim reciprok dhe paqe (Ligjëruesi bashkëpunon me të tjerët në mënyrat që...); d. Të mësosh për t'u bërë merret me zhvillimin e atributëve personale të individit dhe aftësinë për të vepruar me më shumë autonomi, gjykim dhe përgjegjësi personale në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm (Ligjëruesi është dikush që...).

A keni kompetenca për të edukuar mbi zhvillimin e qëndrueshëm?

- Kontrolloni veten përmes skemës të figura 5.
- Kuptoni nivelin tuaj të kompetencave dhe punoni në avantazhet tuaja reale, dobësitë dhe mangësitë, për të zhvilluar profilin tuaj në arsim dhe me qëllim që të zbatoni EZHQ plotësisht në institucionin arsimor/sistemin ku punoni.
- Mos u shkurajoni nëse jeni në nivelin fillestar ose larg pritshmërive tuaja. Nuk ka rëndësi se ku jeni, por ku doni të shkoni!

Prandaj, para se të filloni, janë disa aspekte të rëndësishme personale që duhet të kontrolloni me “veten tuaj të brendshme”:

- A ndjeni entuziazëm ndaj mjedisit dhe a keni nevojë të investoni në programet e mbrojtjes së mjedisit?
- A keni dëshirë dhe motivim që të rriteni vazhdimisht dhe të zhvilloni aftësitë personale dhe profesionale?
- A jeni optimist?




Figura 5: Kompetencat e EZHQ nga raporti “Të mësosh për të ardhmen” (UNECE 2012 fq. 8)

Zhvillimi dhe aktivitetet/strategjitë e EZHQ për shkollën tuaj

A shfrytëzon shkolla juaj rastin që të vë theks të veçantë në rrethana të ndryshme te aktivitetet kyçe të shoqërisë së qëndrueshme? A shënon shkolla juaj ditët e mbrojtjes së mjedisit, a organizon ngjarje të gjelbra në të hapur? A angazhohet në mënyrë të programuar apo herë pas here? A ka zgjedhur dhe integruar shkolla juaj aspektet e mjedisit në kurikulën mësimore ose kjo varet vetëm nga vullneti i mësuesve të interesuar? A investon shkolla juaj në kopshtin e gjelbër dhe izolimin e objekteve apo nuk zbaton fare politikat e gjelbra? A bashkëpunon me pjesëmarrës të jashtëm si OJQ ose institucionet komunale me qëllim të mirëkuptimit dhe përfshirjes në aktivitetet e mbrojtjes së mjedisit apo nuk ka fare një rrjet të tillë?

Pavarësisht nëse shkolla juaj gjendet në njërën ose asnjërën prej situatave të lartpërmendura, shkolla juaj dhe ju jeni të gatshëm gjithmonë për të ndërmarrë iniciativë dhe për t'u bërë modeli i duhur i qëndrueshmërisë. Elementi kyç është besimi, dëshira, ndarja e kohës, planifikimi i saktë, dhe më e rëndësishmja, të mbeteni të motivuar për ta realizuar këtë.

1 Si fillim - shkolla juaj mund të bëhet shkollë e gjelbër!

a) A ëndërroni për shkollën tuaj të gjelbër? Ndajeni këtë mendim dhe formoni një “Ekip të gjelbër”

Hidhni hapin e parë dhe ndani idenë tuaj për “Shkollën e gjelbër” me aktorë të ndryshëm, duke përfshirë stafin e shkollës, partnerët dhe bashkëpunëtorët, prindërit, nxënësit, profesionistët e fushës, vullnetarët nga komuniteti etj. Mësoni se kush është i interesuar dhe formoni bashkë “Ekipin e gjelbër”. Bini dakord për misionin e grupit, vendosni qëllime realiste me plan të qartë të punës, me kornizë kohore dhe rolet dhe përgjegjësitë e përbashkëta.

EKIPI I GJELBËR I SHKOLLËS													
Misioni													
Objektivat													
Anëtarët dhe rolet e tyre													
PLANI I PUNËS													
Aktivitetet	Korniza kohore (nr. I muajve)												Personi përgjegjës
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	

Shënimet këshillimore:

- Caktoni qëllimin që “Ekipi i gjelbër” të bëhet përfshirës dhe që anëtarët e tij të kenë përfaqësi të gjerë si nga sektorët e ndryshëm dhe menaxhmenti brenda strukturave të shkollës, ashtu dhe nga qarqet e jashtme të partnerëve dhe qarqet e lidhura. Nëse nuk mund të marrin pjesë si anëtarë të drejtpërdrejtë, sigurojuni pjesëmarrje në takimet e

“Ekipit të gjelbër” në mënyrë që ata të japin mbështetjen e tyre dhe të ndajnë ide dhe këshilla profesionale.

- Mos i nënvlerësoni studentët/nxënësit si pjesë e Ekipit të gjelbër. Rekomandohet që Ekipi i gjelbër të ketë nxënës që përfaqësojnë çdo nivel, interesime dhe angazhime të ndryshme. Ndoshta do të doni të orientoni nxënësit që të bëjnë punë vullnetare dhe të udhëheqin një program efikas i Shkollës së gjelbër në të ardhmen e afërt.
- Është shumë e rëndësishme që kur t’ju zë entuziazmi gjatë punës të mos harroni të prezantoni dhe të fusni “Ekipin e gjelbër” në struktura kompetente për vendimmarrje brenda shkollës dhe të merrni miratimin e tyre zyrtar për këtë nismë.

b) Caktoni rregulla të qarta por fleksibile të punës për „Ekipin e gjelbër“

Përshtasni “Ekipin e gjelbër” në mënyrë që të jetë fleksibile, për të përmbushur nevojat e rrethanave specifike të shkollës suaj dhe për të shfrytëzuar sa më mirë strukturat dhe resurset ekzistuese. “Ekipi i gjelbër” si fillim ka një rol të qartë dhe kryesor: Të përgatisë planin e veprimit të shkollës së gjelbër me udhëzime për angazhimin e të gjithë shkollës, të bëjë monitorim/kontroll fillestar të zbatimit të planit dhe të sigurojë linja të forta komunikimi në mënyrë që çdo anëtar shkollë të informohet në kohë. *Mbani mend!* Qëllimi i parë i Ekipit të gjelbër duhet të jetë “Deklarata për vizionin e mjedisit” të shkollës suaj, e cila duhet të jetë synimi i çdo anëtari. Për këtë deklaratë duhet të bien dakord të gjithë dhe versioni i saj përfundimtar duhet të jetë në dispozicion të të gjithëve në ambientet e shkollës si dhe në platformat e saj.

Shembujt e deklaratës së shkollës mbi vizionin e mjedisit

“Të mbjellim farën e kureshtjes, kreativitetit dhe inovacionit në një ambient kultivues dhe frymëzues të të nxënësve, ku të gjithë nxënësit lirojnë potencialin e tyre të plotë për një të ardhme më të mirë” (Shkolla finlandeze Oman)

“Angazhimi aktiv i nxënësve, kuadrove dhe komunitetit për zhvillimin e një ambienti të qëndrueshëm që kultivon dhe nxit praktikën më të mirë duke theksuar rëndësinë e përgatitjes dhe fuqizimit të individëve që të bëhet të përgjegjshëm në dhënien e kontributit të tyre për një të ardhme të qëndrueshme” (Shkolla fillore Beaumaris)

“Çdo nxënës i shkollave shtetërore në Boston do të ketë shkollë të shëndetshme dhe të qëndrueshme” (Shkollat shtetërore të Bostonit)

Shënimet këshillimore:

- “Ekipi i gjelbër” duhet të takohet rregullisht dhe takimet duhet të jenë përfshirëse dhe transparente, ndërsa procesverbalet e takimeve duhet të jenë në dispozicion të të gjithëve
- Nxënësit nxënësit që të fillojnë të kryesojnë takimet dhe prisni nga nxënësit anëtarë të “Ekipit të gjelbër” të shprehin idetë e tyre në takime, si dhe komente dhe propozime etj. dhe prisni nga nxënësit e tjerë në shkollë që të angazhohen që këto informacione nga takimet të arrijnë tek të gjithë ata.
- Mësoni nga shkollat e tjera në rajonin tuaj ose në nivelin global. Shembujt rajonalë promovohem më pak dhe janë sporadikë, por me siguri ekzistojnë! Nxënësit bisedë me shkollat që gjenden në listën tuaj të kontakteve! Ndërkohë, shumë shembuj globalë të

suksesit dhe studime të rastit kanë qasje të hapur, dhe shumë struktura, platforma dhe rrjete ekzistuese janë të hapura për bashkëpunim me ju!

- Ndoshta do të doni të vizitoni faqet e internetit dhe të frymëzoheni nga nismat për shkollat e gjelbra në vijim: Programi i vëllazërimit të eko-shkollave: www.ecoschools.global; Eko-shkollat e Irlandës së Veriut: www.eco-schoolsni.org; Green Standard School www.greenstandardschools.org/ Shkollat shtetërore të Bostonit: www.bostongreenschools.org; Program për shënimin e shkollave të gjelbra të Floridës: www.floridadep.gov; Nisma për shkollat e gjelbra: <http://www.greenschools.net/>; Projekti i shkollës së gjelbër www.projectgreenschools.org/; Qendra e shkollave të qëndrueshme www.sustainableschools.natureconnect.earth

„Ekipi i gjelbër“ është zemra e shkollës suaj të gjelbër dhe meriton vëmendje dhe kohë për t’u bërë i konsoliduar, funksional dhe operacional. Prandaj mos t’ju vijë keq për kohën tuaj, investojeni atë jo vetëm për të formuar ekipin, por edhe për të ruajtur angazhimin dhe motivimin e vazhdueshëm të ekipit!

2 Rishikimi inicial i shkollës suaj mbi ndikimin në mjedis

Në përputhje me “Parimin e qëndrueshmërisë në nivelin e shkollës”, Rishikimi inicial mbi ndikimin ndaj mjedisit duhet të fillojë paralelisht në tre dimensione: 1) Në çfarë niveli janë përfshirë parimet, vlerat dhe temat e qëndrueshme në kurikulën mësimore; 2) Sa reflektohet qëndrueshmëria nga administrata e shkollës dhe praktikat operative dhe 3) A ka bashkëpunim të vazhdueshëm midis shkollave dhe komunitetit? Ky është objektivi i dytë gjithëpërfshirës i Ekipit të gjelbër, ku do të formohen nënëkipe sipas roleve dhe detyrave të anëtarëve të cilët do të zbatojnë këtë auditim paralel.

Rishikimi inicial mbi ndikimin ndaj mjedisit është momenti kyç i përkushtimit tuaj ndaj shkollës së gjelbër. Hapi i parë drejt zvogëlimit të ndikimit ndaj mjedisit është matja e tij, dhe auditimi do t’ju ofrojë qasje në ndikimin real të shkollës suaj ndaj mjedisit. Në këtë fazë shkolla do të kuptojë se cilat elemente të punës dhe aktivitetit të saj shkaktajnë ndryshime në mjedis (pozitive dhe negative). Është një moment i rëndësishëm sepse ai do të ndihmojë në përshtatjen e qasjes së ardhshme të gjelbër me mënyrën reale të funksionimit të shkollës, në vend të imponimit të ndryshimeve nga jashtë.

Për nevojat e këtij udhëzuesi, ky hap do të fokusohet te dimensionin e menaxhimit dhe performancës së shkollës, do të prekim shtyllën e kurikulës mësimore, dhe në mënyrë indirekte, përmes partneriteteve të gjelbra të shkollës dhe komunitetit lokal.

Ka mënyra të ndryshme të konceptimit, qasjes dhe zbatimit dhe Rishikimit inicial të ndikimit ndaj mjedisit. Megjithatë, duhet të përgatiteni dhe të njiheni gjithmonë me politikën e shkollës dhe me nivelin e orientimit të implementimit të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në shkollën tuaj.

a) Bëni auditimin e politikave tuaja shkollore!

Rishqyrtoni politikat tuaja shkollore dhe mësoni se në çfarë mase ato mbulojnë dhe reflektojnë parimet dhe elementet e qëndrueshmërisë. Ky hap zakonisht zakonisht nënkupton rishqyrimin e politikave ekzistuese të menaxhimit dhe punës së shkollave dhe kontrollon nëse në këto politika dhe dokumente përmendet ose interpretohet pranimi i parimeve dhe elementeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Analizat mund të thellohen dhe mund të shprehen nëse:

- 1) Mendoni se përmbajtja e tyre është e mjaftueshme;
- 2) Jepni rekomandime për përmirësimin e tyre nëpërmjet ndryshimit të politikave ose krijimit të politikave të reja specifike që harmonizojnë punën e shkollës me edukimin për zhvillim të qëndrueshëm dhe kontribuojnë për një shoqëri të qëndrueshme.

Hapi i radhës së kësaj detyre mund të jetë: a) bisedë me strukturat kompetente për vendimmarrje b) përfshirja e ndryshimeve të qëllimeve tuaja në mënyrë që të përfshini zhvillimin e ardhshëm të shkollës së gjelbër.

b) Vlerësoni nivelin e inkorporimit të qëndrueshmërisë në kurikula mësimore

Për të pranuar qasjen praktike në auditimin e kurikulave mësimore, u këshillojmë anëtarëve të Ekipit të gjelbër që kanë marrë përsipër këtë përgjegjësi (në ekip për kurikulën e gjelbër mësimore) që të identifikojnë dhe të ndajnë dy nivele të rëndësishme të bazuara mbi shtyllat kryesore të rezultateve të të mësuarit të EZHQ-së:

- 1) Njohuria - përfshin të gjitha informacionet mbi mjedisin që ofrohen dhe mësohen në shkollën tuaj. Burim i mirë janë kurikulat mësimore, planet e lëndëve të caktuara, tekstet shkollore dhe publikimet referente që përdorin mësuesit në disipinat e tyre, gjatë orëve të mësimi, gjatë orëve pa pagesë etj.
- 2) Aftësitë dhe qëndrimi - përfshijnë të gjitha metodat dhe instrumentet mësimore që përdorin ligjëruesit e shkollës suaj gjatë orëve të tyre në mënyrë që t'u mundësojnë nxënësve që të zhvillojnë aftësitë, të marrin qëndrimet dhe të formojnë një të ardhme të qëndrueshme (shiko më lart *"Si duhet të zbatohet edukimi mbi ZHQ"*)

Hapat udhëheqës për auditimin e kurikulës mësimore janë:

- Koordinimi dhe bashkëpunimi me të gjithë mësues në shkollë! Nënëkipi juaj i gjelbër duhet të koordinohet dhe të bashkëpunojë me të gjithë mësues në mënyrë që të kërkojë informacione për një auditim të shpejt, cilësor dhe gjithëpërfshirës. Caktoni takim me mësuesit e shkollës dhe jepuni informacione dhe udhëzime përkatëse mbi gjërat që duhet të kontrollojnë në kurset që japin, dhe mbi mënyrën e kontrollit dhe komunikimit të rezultateve.
- Bini dakord me ekipin tuaj rreth përzgjedhjes së temave të EZHQ-së të cilat do të donit t'i shqyrtonit në kuadër të kurikulave mësimore:
 - Duke u lidhur me OZHQ, këto janë disa tema kyçe nga fusha e mjedisit që duhet t'i kërkonit në kurikulat tuaja dhe jo vetëm: biodiversitet, energjia, uji, mbeturinat, transporti, ndryshimet klimatike dhe ushqimi. Mund t'i mbindërtoni ato duke i grupuar ose ndarë në njësi më të vogla dhe duke integruar tema të reja horizontale siç është pjesëmarrja, ndërgjegjësimi, komunikimi etj.
 - Gjatë përzgjedhjes së temës për EZHQ, objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm gjithashtu mund të jenë burim i frymëzimit.
- Në varësi nga lloji i shkollës dhe niveli i mësimit, gjatë përzgjedhjes së temave mbi EZHQ, gjithashtu mund të merrni parasysh dhe shtyllat e Agjendës së gjelbër për Ballkanin Perëndimor: 1) Mbrojtja e klimës dhe dekarbonizimi me qëllim të uljes së emetimit të gazrave me efekt serre dhe harmonizimit me neutralitetin karbonik të BE-së deri në vitin 2050; 2) Lëvizja drejt ekonomisë cirkulare; 3) Zvogëlimi i ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës; 4) Përmirësimi i metodave të qëndrueshme të prodhimit të ushqimit; dhe 5) Mbrojtja e biodiversitetit dhe të ekosistemeve.
- Analizoni dhe dhënat dhe strukturoni rezultatet tuaja! Ky hap është shumë i rëndësishëm sepse ai përbën rezultatin thelbësor të auditimit, në bazë të të cilit do të mbindërtoni programin tuaj të EZHQ-së. Mendoni me kujdes për këtë hap ku ndoshta do t'ju duhet mbështetja e shpeshtë të anëtarëve të ekipit tuaj që zotërojnë aftësi nga fusha e IT-së dhe statistikës.

Shënimet këshillimore

- Zhvillimi i qëndrueshëm në kurikulat mësimore është një komponent i gjerë dhe kërkuar. Duhet të jeni të vetëdijshëm dhe real në lidhje me këtë, por si gjithmonë, më e rëndësishmja është të shqyrtoni dhe të filloni, dhe të mos e anashkaloni ose shtyni për më vonë!
- Fillimi modest është në rregull! Mësoni të harmonizoni pritjet tuaja me kontekstin e punës suaj dhe nivelin e mësimdhënies. Për shembull, nëse bëhet fjalë për një shkollë fillore, përshtasni pritjet dhe përpjekjet tuaja me nivelin e mësimdhënies. Nëse bëhet fjalë për një shkollë të mesme profesionale, shfrytëzoni përparësitë e këtij sektori specifik dhe filloni më së pari në këta sektorë (për shembull, në rast të shkollës bujqësore, filloni me aktivitetet në lidhje me prodhimin e qëndrueshëm të ushqimit ose ndotjen e tokës)
- Është në rregull të merrni parasysh ndihmën e edukatorit ose mentorit për këtë hap! Nëse ende mendoni që keni vështirësi me fillimin dhe finalizimin, bisedoni me të gjithë anëtarët e Ekipit të gjelbër mbi mundësinë për të pasur një edukator ose mentor i cili mund t'ju udhëheqë dhe t'ju mbështesë në këtë hap. Mund të gjeni ekspertë të tillë në kuadër të resurseve të brendshme të shkollës suaj, të shkollave në afërsi që ndoshta kanë më shumë përvojë në këtë fushë, mes bashkëpunëtorëve, palëve të interesuara, prindërit ose bisedoni me personat kompetent për vendimmarrje në shkollë në mënyrë që të mbliidni fondet për angazhimin e ekspertëve.
- Mos bini në kurth dhe të mendoni që ZHQ duhet të përmendet në çdo diskutim! Termi i ZHQ mund të mos përmendet kurrë shprehimisht në përmbajtjen e kursit, disiplinës, modulit etj. Në vend të kësaj, mund të përmenden çështjet e ndotjes, depozitimi i mbeturinave, mbrojtja e natyrës etj. që e bëjnë përmbajtjen të qëndrueshme në mënyrë implicite. Pra, kurikulat tuaja mësimore mund të futen një njërën ose disa kategori në vijim: 1) ZHQ është integruar plotësisht në kurs (në mënyrë eksplicite ose implicite); 2) ZHQ përmendet në një modul të caktuar të kursit (në mënyrë eksplicite ose implicite); 3) ZHQ nuk përmendet (as në mënyrë eksplicite dhe as implicite), por mund të shihni se ku do të mund të përshtatej dhe 4) ZHQ nuk mund të integrohet lehtë në kurs.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e ZHQ në kurikulat mësimore dhe hapësirën e kufizuar të këtij udhëzuesi, do të japim dy shembuj praktik për ta konkretizuar teorinë.

Shembujt praktikë të integritit të ZHQ-së në kurikulat mësimore:

Integrimi i EZHQ-së në kualifikimet profesionale (Integrimi i zhvillimit të qëndrueshëm në kurikulën mësimore, fq. 9)

Kursi i parukerisë me shumë mundësi do të mbulojë temat në vijim: Bisedë me klientin në lidhje me stilin e flokëve, dhënia e këshillave dhe ideve për stilet e ndryshme, shamponim dhe kondicionim; prerje dhe stilizim; lyerje, ondulum dhe drejtim; këshillim për problemet e vogla të flokëve dhe të lëkurës së kokës; caktimi i orareve dhe marrja e pagesave; porositja e materialeve, prokurimi i flokëve natyrale për zgjatje flokësh dhe paruket.

Për të kuptuar se ku mund të integrohet ZHQ në këtë kualifikim, duhet të shikojmë materialet që përdoren gjithashtu në këtë profesion: Energjia; përdorimi i kimikateve (bojrat e flokëve, shampot etj.); uji; floku natyral; pajisje parukierësh (tharëse, hekur, peshqira etj.); kancelari (komputera, letra etj.).

Përfshirja e OZHQ-ve në kurikulën tuaj mësimore (www.cambridge.org)

Në pothuajse çdo leksion mund të gjeni të paktën një OZHQ; vetëm duhet të dini se si ta shikoni. Në një leksion tipik mbi ushqimin, fokusi ynë është te fjalori i ushqimeve dhe herë pas here reflektojmë ushqimin e shëndetshëm tradicional. Nëse shikojmë pak më thellë, mund të shohim që leksioni i ushqimit përmban 4 OZHQ shumë të dukshme.

OZHQ1: Nuk ka varfëri (ka një arsye përse quhet jeta nën kufirin e varfërisë)

OZHQ2: Nuk ka uri (uria do të thotë të jesh pa ushqim)

OZHQ3: Shëndeti i mirë dhe mirëqenie (ushqimi ka ndikim të madh te shëndeti ynë fizik dhe mendor)

OZHQ12: Shpenzimi dhe prodhimi përgjegjës (produktet që konsumojmë kanë ndikime të ndryshme në mjedis, në mirëqenien e kafshëve dhe njerëzit.)

Fokusi tek OZHQ 3 është po aq i pranishëm edhe tek mësuesit dhe në tekstat shkollore sepse ushqimi lidhet qartë me ushqyerjen, që lidhet me shëndetin. Sheqeri = keq, perimet = mirë. Si mësues, mund të shikojmë shumë më thellë se kaq dhe mund t'u japim nxënësve tanë mundësi që të gjejnë se çka tjetër ka lidhje me ushqimin, përveç atyre që fusim në organizmin tonë. Nëse u ofrohet mundësia, shumica e nxënësve do të mund të gjejnë të katër OZHQ të lartpërmendura, por ndoshta dhe më shumë.

c) Pasqyra e qëndrueshmërisë në menaxhimin e punës së shkollës në bazë të eko-hartimit

Eko-hartimi u zhvillua nga eko-konsultanti Heinz-Werner Engel nga Brukseli si instrument të thjeshtë, vizual dhe praktik për skanimin e praktikave të mira dhe të këqija në fushën e mjedisit, problemeve dhe ndikimeve të një organizate të caktuar dhe në mënyrë që të merret qasja në gjendjen aktuale të mjedisit. Këtë instrument është pranuar dhe miratuar për përdorim në shkolla. Ai ndihmon në përkufizimin dhe përcaktimin e prioriteteve nga pikëpamja e problemeve dhe çështjeve nga fusha e mjedisit për të cilat kërkohet që të ndërmerren aktivitete sepse: 1) kuptohet lehtë; 2) mundëson pjesëmarrje dhe përfshirje të numrit më të lartë të njerëzve dhe të stafit në këtë fazë të hershme të qasjes së gjelbër; 3) nuk kërkon ekspertizë të madhe nga fusha e mjedisit për t'u përdorur siç duhet dhe për të nxjerrë përfitim nga përdorimi i tij. Eko-hartimi realizohet në 10 hapa dhe përfshin kornizë kohore prej një viti:

1) Imazhi i gjerë i lokacionit të shkollës suaj - çfarë tregon?

Duhet të kuptoni dinamikën e lokacionit të shkollës suaj. Bëni një hartë të lokacionit me pamje nga lart, duke përfshirë parkingje, vendet e qasjes, zonën përreth dhe hartoni aktivitetet tuaja shkollore në të hapur. *Çfarë ju tregojnë këto? Si ndikojnë te mjedisi?*

2) Analiza e hyrjeve dhe daljeve - çfarë hyn dhe çfarë del nga shkolla juaj

Ky hap kërkon nga ju që të merrni informacione mbi materialet dhe natyrën e tyre (materialet e rrezikshme, ekologjike, riciklueshme etj.) që hyjnë ose dalin nga shkolla juaj, duke përfshirë shërbimet, emetimet etj. Bashkë me njësit, paraqisni të dhënat mbi: Cilësinë, sasinë, natyrën e tyre, a u është dhënë shenja ekologjike, a janë të përshtatshëm për mjedisin etj. dhe vendosni se çfarë meriton më shumë vëmendje për ndërmarrjen e aktiviteteve.

Në tabelën e mëposhtme gjendet lista e produkteve që mund të përshtaten dhe të përshkruhem në mënyrë më të detajuar për nevojat e çdo shkolle.

Hyrjet (në vit)	Shpenzimi*	Natyra e produktit	Daljet (në vit)	Prodhimi*	Natyra e produktit
Deterxhente			Produkte		
Bojra			Mbeturinat komunale		
Tretës			Mbeturinat e ricikluara		
Kancelari			Mbeturinat e rrezikshme		
Komputera			Mbeturinat ushqimore		
Elektronikë			Ujerat e zeza		
Shpenzimi i ujit			Emetimet		
Shpenzimi i energjisë			Ndotja e tokës		
Gaz			Erërat e pakëndshme në ajër		
Naftë, karburant			Niveli i zhurmës		
....				

* Masni shpenzimin dhe prodhimin me njësi përkatëse si litra, kg, m3 etj.

Natyra e produktit mund të identifikohet sipas 7 kategorive në vijim: 1 – Dhënia e shenjës Eko; 2- E ricikluar; 3 – Korrozivë; 4- E rrezikshme për mjedisin; 5 – E ndezshme; 6- E dëmshme dhe 7 – Toksike.

3) Analiza e opinionit publik

Kjo është periudha kur në auditimin e ndikimit ndaj mjedisit përfshihen mendimet dhe idetë e stafit dhe anëtarëve të shkollës, duke përfshirë dhe nxënësit, duke zbatuar një hulumtim të shkurtër prej dy minutave, që Engel e quan „Harta meteorologjike“ e mjedisit. Në këtë hap kërkoni nga ata që të shënojnë përgjigjet e tyre shpejt dhe në mënyrë intuitive në mënyrë që të merrni një ide se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe në administratën e shkollës. Në formularin e mëposhtëm mund të përshtasni aktivitetet e ofruara me aktivitetet e shkollës suaj.



Përdorimi i lëndëve të para, produkteve dhe resurseve					
Përdorimi dhe përzgjedhja e energjisë (karburant, gaz, energji elektrike)					
Përdorimi i ujit dhe të ujërave të zeza					
Parandalimi dhe zvogëlimi i mbeturinave					
Riciklimi dhe ndarja selektive e mbeturinave					
Ndotja e ajrit, pluhuri dhe erëra të pakëndshme					
Zvogëlimi dhe kontrolli i zhurmës dhe vibracioneve					
Magazinimi i produkteve					
Mobiliteti dhe transporti i punonjësve dhe të mallrave					
Planifikimi i gjelbër për produktet dhe shërbimet					
Siguria dhe shëndeti në punë					
Parandalimi i aksidenteve në mjedis					
Informacionet mbi mjedisin (të brendshme dhe të jashtme)					
Komunikim me furnizues dhe nënkontraktorë					
Fqinjësi (dialog dhe implikime)					
Motivimi i menaxherit					
Motivimi i punonjësve					
Praktikat e menaxhimit të mjedisit					

Figura 6: „Harta meteorologjike“ e mjedisit, Eko-hartim© Heinz Werner Engel

Shënim!


Ky është një moment i rëndësishëm në auditimin tuaj sepse: Nuk doni që auditimi juaj inicial mbi ndikimin ndaj mjedisit të reflektojë vetëm konkluzionet dhe mendimet e anëtarëve të ekipit të angazhuar për nevojat e auditimit. Duhet të bëni përpjekje që të përfshihen të gjithë. Në punën tuaj të ardhshme duhet t'i tregoni shkollës që jeni duke u marrë me çështjet dhe mangësitë që nuk përbëjnë shqetësime të një grupi të vogël të njerëzve, por janë shqetësimet e identifikuara nga të gjithë anëtarët.

4-9) Hartoni shkollën tuaj

Është koha që të hartoni performancën ekologjike të aktiviteteve brenda shkollës suaj. Është e nevojshme që të bëni një hartë të vërtetë të planimetrisë së kateve të shkollës, e cila duhet të jetë e thjeshtë, e identifikueshme dhe proporcionale. Harta duhet të përmbajë datën, emrin dhe qëllimin.

Shumëzoni këtë eko-hartë me numrin e temave të cilat do të donit të shqyrtonit në kuadër të performancës së shkollës suaj ndaj mjedisit. Mund të filloni me njëren ose më shumë ose të gjitha nga temat në vijim nga fusha e mjedisit: 1) Mbeturinat, 2) Uji, 3) Energjia, 4) Cilësia e ajrit, erërat e pakëndshme, zhurma dhe 5) Biodiversiteti. Mund të gruponi, ndani, shtoni ose fshini tema sipas nevojave tuaja dhe sipas vlerësimit të ekipit të gjelbër të shkollës. Çdo eko-hartë do të plotësohet veç e veç në mënyrë që të fokusohemi më mirë te tema dhe për të marrë informacione më të dobishme. Për të kursyer kohë dhe për të arritur fokusin maksimal, mund të shqyrtoni ndarje në grupe ku çdo grup do të jetë përgjegjës për temë të ndryshme. Figura 7 shërben për t'ju orientuar, kurse formularin e hartimit mund ta gjeni në anekset e udhëzuesit.

Elemente/segmente të rëndësishme të eko-hartës janë:



- Problemet e mjedisit dhe serioziteti i tyre - edhe pse mund të shënoni problemet e mjedisit, mund të zhvilloni dhe simbolet që tregojnë nëse bëhet fjalë për një problem të madh apo të vogël. Simbolet që përdoren janë: Vijat e hijezuara: Problem i vogël (fushë që duhet monitoruar, problem që duhet studiuar); rrethi: Problem i madh (ndalimi i masat korrigjuese). Sa më serioz problemi, aq më i trashë rrethi.
- Shkaku i problemit të mjedisit - sjellja, pajisjet, procesi ose njohuritë dhe aftësitë
- Faktet + të dhënat numerike + treguesit e mjedisit – këto elemente sqarojnë se nga i keni marrë të dhënat (duke treguar kështu se sa të sakta janë) dhe çfarë vëzhgohet/matet konkretisht.. Çdo Ekip i Gjelbër i shkollës mund të krijojë treguesit e vet specifikë të mjedisit për matjen e çdo teme.
- Shpenzimet – është një element i rëndësishëm dhe këshillohet që mos ta harroni kurrë kur jeni duke bërë auditimin e ndikimit ndaj mjedisit.

Figura 7: Shembulli i një eko-harte të përfunduar (nga Belgjika), (www.paeger-consulting.de)

10) Organizoni, menaxhoni dhe komunikoni

Është e rëndësishme që të menaxhoni dhe organizoni informacionet dhe aluzionet që do të merrni nga eko-harta dhe analiza “meteorologjike”. Rekomandohet të përgatitni raportet përkatëse me një përmbledhje të efekteve të shkollës suaj ndaj mjedisit, duke treguar pikat e identifikuar kritike, të përcaktoni prioritetet dhe t’i komunikoni rezultatet në mënyrë korrekte jo vetëm stafit të shkollës dhe strukturave udhëheqëse dhe nxënësve, por edhe anëtarëve të komunitetit tuaj lokal. Ky moment është gjithashtu i rëndësishëm sepse ju çon drejt planit tuaj të veprimit të shkollës së gjelbër në të cilin do të identifikoni aktivitetet dhe përcaktoni prioritetin e zbatimit të tyre.

3 Plani i veprimit të shkollës së gjelbër

Plani i veprimit për gjelbërimin e shkollës suaj do të mbështetet te rezultatet e auditimit të ndikimit ndaj mjedisit. Rishikimi i ndikimit ndaj mjedisit do të nxisë vendosjen e qëllimeve dhe rezultateve të pritura që duhet të arrihen pas një viti. Bëhet fjalë për tërësinë e qëllimeve dhe rezultateve që doni të arrini dhe listën e aktiviteteve që do të donit të zbatonit brenda kohës së caktuar. Formulari në vazhdim mund t’ju hyjë në punë si model referues gjatë dizajnit të planit tuaj të veprimit. Mund ta përshtasni me nevojat dhe rrethanat tuaja, ndërsa ai do të implementohej saktë nëse mbani të paktën të njëjtin nivel informacionesh. Dhe natyrisht, nëse doni, gjithmonë mund të shtoni më shumë elemente dhe detaje (figura 8).

PLANI I VEPRIMIT						
Tema	Mbeturina					
Problemi i identifikuar 1:	Aktivitetet që do të ndihmojnë arrijtjen e rezultatit(çka)	Person përgjegjës (kush)	Afati (kur)	Kosto financiare (sa)	Përmirësime të propozuara	Rezultati real
Qëllimi:						
Rezultati i pritur						
Rezultati 1: _____						
Indikatorët						
1 _____						
2 _____						
3 _____						
Rezultati 2: _____						
Indikatorët						
1 _____						
2 _____						
3 _____						

8: Formulari i propozuar i planit të veprimit

Motivimi dhe entuziazmi mund të nxisin Ekipin e gjelbër që të krijojë dhe të bie dakord rreth një plani optimist të veprimit që tejkalon realitetin. Kjo mund të cenojë të gjithë punën dhe rezultatet e arritura, por edhe mund të demotivojë dhe të frustrojë ekipin në zbatimin dhe realizimin e qëllimeve të planifikuara. *Atë nuk e duam!*

Shënimet këshillimore mbi planin realist të veprimit

- Le të jetë i bazuar vetë mbi rezultatet e auditimit tuaj të ndikimit ndaj mjedisit. Mos e zgjeroni në mënyrë që të mbulojë çështjet më të gjera të mjedisit.
- Hartoni planet e veçanta të veprimit për temat individuale nga fusha e mjedisit në mënyrë që të mbani fokusin tek rezultatet dhe të planifikoni aktivitetet konkrete.
- Caktoni qëllimet specifike, të matshme, të arritshme, të orientuara te rezultate dhe me kufizim kohor, që zakonisht fokusohen tek/përbëjnë ndryshimin e gjendjes së problemit të identifikuar.
- Le të tregojnë indikatorët që po funksionon! Kjo do të thotë se caktimi i sa më shumë indikatorëve specifik dhe të matshëm të rezultateve tuaja do ta lehtësojë punën tuaj dhe do të tregojë ecurinë e aktivitetit.
- Le të jetë i shkurtër dhe i shkëlqyer! Identifikoni qëllimin dhe filloni në mënyrë modeste, në shumicën e rasteve rëndësi ka të fillosh.
- Jepini mundësi vetes për të rishikuar dhe përditësuar planin! Gjatë implementimit të planit mund të mësoni nga gabimet tuaja, nga përvojat e të tjerëve, mund të kuptoni se planifikimi është i gabuar në një moment të caktuar etj. Hartoni një plan të përshtatshëm që i ofron ekipit tuaj fleksibilitet për të përmirësuar dhe përditësuar punën.
- Plani juaj i veprimit duhet të jetë në dispozicion të publikut! Çdo anëtar dhe bashkëpunëtor i shkollës suaj duhet të ketë informacione mbi Planin e veprimit, në mënyrë që të jetë i njoftuar për të dhe të marrë pjesë në zbatimin e tij.
- Mos harroni të festoni! Do të ketë kaq shumë ditë të mbrojtjes së mjedisit dhe kaq shumë arritje të cilat do t'i shijoni teksa jeni duke zbatuar planin tuaj të gjelbër të veprimit. Zgjidhni objektivat kyçe dhe festojini me të gjithë anëtarët dhe partnerët e shkollës suaj.

4 Monitoroni, përshtasni dhe mbindërtoni

Kur të filloni me implementimin e planit të veprimit, do të jetë e nevojshme që të dini se si po ecën dhe të kuptoni nëse jeni në rrugën e duhur për të arritur qëllimet tuaja, kështu që do të jetë e nevojshme që të bëhet monitorimi periodik.

Shënimet këshillimore

- Ekipi juaj i gjelbër duhet të bashkërendojë periodicitetin e monitorimit, por duhet t'u jepni mundësi dhe përgjegjësi nxënësve që të zbatojnë aktivitetet e monitorimit.
- Indikatorët dhe rezultatet tuaja do të orientojnë metodat e monitorimit që do të hartoni dhe ndërmerrni.
- Rezultatet e monitorimit duhet të shfaqen publikisht në mënyrë që të gjithë anëtarët e shkollës dhe partnerët të mund të shohin dhe të jenë në dijeni mbi ecurinë e shkollës suaj të gjelbër.

Në fund të vitit, pas monitorimit periodik vjen vlerësimi i suksesit të aktiviteteve, i cili do t'ju ndihmojë që të bëni ndryshime në planin tuaj të veprimit nëse është e nevojshme. Disa nga rrethanat ku mund të ketë nevojë për ndryshime: Nuk ecni përpara dhe duhet të përshtasni aktivitetet; keni përparuar shumë dhe ju duhen rezultate të reja; keni përparuar shumë dhe duhet të reflektoni ecurinë dhe të riorientoni kurikulat mësimore, menaxhimin dhe ndërgjegjësimin; keni përparuar dhe dëshironi të zgjeroni aktivitetet dhe temat për gjelbërimin e shkollës suaj etj.

Integrioni qasjet e ekonomisë cirkulare në nismën tuaj për shkollat e gjelbra

Ekonomia cirkulare konsiderohet si aktivitet i nevojshëm tashmë për krizën e qëndrueshmërisë - duke përfshirë dhe ndryshimet klimatike, humbjen e biodiversitetit, përdorimin e tepërt të burimeve natyrore dhe ndotjen. Aktiviteti më i rëndësishëm është ndalimi i shpenzimit të pafund, duke kaluar nga ekonomia lineare në ekonomi cirkulare me neutralitet të karbonit.

Ka shumë shpjegime të ndryshme të ekonomisë cirkulare. Në këtë udhëzues do të reflektojmë shpjegimin e dhënë nga Fondacioni Ellen MacArthur “*Ekonomia cirkulare është një sistem ku materialet kurrë nuk bëhen mbeturina dhe ku rigjenerohet natyra. Në ekonominë cirkulare produktet dhe materialet qarkullojnë nëpër procese siç është mirëmbajtja, ripërdorimi, rinovimi, riprodhimi, reciklimi dhe kompostimi. Ekonomia cirkulare zgjidh çështjet e ndryshimeve klimatike dhe të sfidave të tjera globale, siç është humbja e biodiversitetit, mbeturinat dhe ndotja, duke ndarë aktivitetet ekonomike nga shpenzimi i resurseve të kufizuara.*” Në ekonominë tonë aktuale në marrim materialet nga Toka, i bëjmë produkte dhe në fund i hedhim si mbeturina - në një proces linear. Ndryshe nga kjo, në ekonominë cirkulare nuk lejojmë fare gjenerimin e mbeturinave. Roli i shkollave në ekonominë cirkulare është me rëndësi thelbësore.

Ekonomia cirkulare bazohet mbi tre parime kryesore: 1) eliminimi i mbeturinave dhe të ndotjes; 2) qarkullimi i produkteve dhe materialeve (gjatë vlerës së tyre më të lartë) dhe 3) rigjenerimi i natyrës. Nxitësi i këtyre parimeve është konceptimi i materialeve dhe produkteve në mënyrë të tillë që të mbeten në qarkullim sa më gjatë.

E thënë më thjeshtë, parimi i ekonomisë cirkulare fton qytetarët, institucionet, kompanitë dhe shkollën tuaj që të veprojnë në përputhje me qasjen “Mbeturinat zero!”

A kërkon kjo punë dhe njohuri shtesë? Jo dhe aq!

Duke ndërmarrë dhe krijuar nisma për shkollat e gjelbra dhe duke zbatuar planin e veprimit, tashmë do të përfshihen në parimet e ekonomisë cirkulare dhe qasjen e mbeturinave zerp, dhe për t'u ndërgjegjësuar në lidhje me këtë dhe për të përmirësuar këto parime, mund të merrni parasysh aktivitetet në vijim në momente të caktuara të gjelbërimit të shkollës suaj:

- Jini të kujdesshëm dhe theksoni parimet e ekonomisë cirkulare në politikat e gjelbra të shkollës suaj, në cilëndo fazë që të jenë. Pra, në politikat e reja të gjelbra të cilat do t'i konceptoni në mënyrë të zero ose duke integruar dhe mirëmbajtur këto parime bashkë me elementet e zhvillimit të qëndrueshëm në të gjitha politikat ekzistuese të shkollës.
- Hartoni dhe zhvilloni kodin e gjelbër të funksionimit të shkollës suaj. Në këtë kod duhet të reflektoni me kujdes elementet që janë në përputhje me parimet e ekonomisë cirkulare, siç janë: *Shkolla jonë prokuron materiale të ricikluara, në shkollën tonë ripërdoren dhe riciklohen gjërat, shkolla jonë ndalon përdorimin e materialeve dhe ambalazheve njëpërdorimëshe etj.*
- Gjatë analizave të hyrjeve dhe daljeve ju do të rendisni materialet, produktet, shërbimet, pajisjet etj. në kategori të ndryshme të shenjave, siç janë: Eko, të rrezikshme etj. Mund të merrni parasysh shtimin e kategorive të tjera siç janë: E ricikluar, e ripërdorur etj.
- Hulumtimi juaj i opinionit publik është një moment tjetër me të cilin mund të kontribuoni në parimet e ekonomisë cirkulare. Ndoshta në këtë fazë do të donit të bënit

një vlerësim me të gjithë anëtarët e shkollës në lidhje me mënyrën se si e shohin ata zhvillimin e politikës së Mbeturinave Zero në shkollë.

- Eko-harta e mbeturinave! Ky është një instrument i drejtpërdrejtë për shtimin dhe auditimin e parimeve cirkulare dhe të praktikave të Mbeturinave Zero. Kjo mund të bëhet duke shtuar sa më shumë tregues të cilët reflektojnë krijimin e mbeturinave dhe praktikave në shkollë.
- Qarkulloni me planin e veprimit të shkollës së gjelbër! Ky është momenti për krijimin e tij, por pas një viti implementimi, gjithashtu përmirësoni qëllimet dhe aktivitetet për shkollën tuaj të gjelbër. Gjithashtu, kjo është periudha më e mirë për t'u angazhuar dhe për të vendosur objektiva specifika të cilat reflektojnë sa më shumë parimet e ekonomisë cirkulare në punën e shkollës.

Shpresojmë që tashmë po synoni që të bëheni të gjelbër dhe cirkularë!

Uditimi i brendshëm i shkollës mbi ngritjen e një shoqërie të qëndrueshme

Pas daljes nga shkolla, kur shijojmë një fundjavë të mirë në natyrë ose luajmë lojën “Të vjelësh apo të mos vjelësh”, ne si mësues dhe ligjërues në shkollë, ose si ekip i gjelbër, duam që të gjithë nxënësit tanë dhe anëtarët e shkollës, duke na përfshirë dhe neve, të marrim një vendim të qëndrueshëm për ta lënë lulen që të rritet dhe të lulëzojë dhe të mos e vjelim. Nëse arrijmë këtë, mund të ndjejmë dhe të konfirmojmë arritjet në edukimin tonë për zhvillim të qëndrueshëm.

Në këtë pjesë të udhëzuesit do të donim t’ju udhëzojmë që të kuptoni nëse dhe sa po kontribuon shkolla juaj me aktivitetet e saj të gjelbra në ngritjen e një shoqërie të qëndrueshme dhe objektivat e qëndrueshmërisë. *A doni të dini se çfarë roli po luani ju në këtë?* Në aneks gjendet një liste e thjeshtë e kontrollit e cila përdor si kornizë 9 parime të shoqërisë së qëndrueshme të propozuar nga strategjia “Kujdesi për Tokën” (shikoni “Parimet kyçe të qëndrueshmërisë” më lart). Parimet janë si më poshtë:

- 1) *Respekti dhe përkujdesja për komunitetin e jetës* - qasja etike e detyrës për t’u kujdesur për njerëzit e tjerë dhe format e tjera të jetës, tani dhe në të ardhmen.
- 2) *Përmirësimi i cilësisë së jetës* - jetë e gjatë dhe e shëndetshme, arsimi, qasja në resurset e duhur për një standard të denjë të jetesës.
- 3) *Ruajtja e vitalitetit dhe të shumëllojshmërisë së Tokës* - aktivitetet për mbrojtjen e strukturës, funksionit dhe shumëllojshmërisë së sistemeve natyrore.
- 4) *Minimizimi i shterjes së burimeve të rinovueshme* - aktivitetet që zgjasin jetën e burimeve të rinovueshme, për shembull, zbatimi i ekonomisë cirkulare.
- 5) *Të mbetemi brenda kufijve të kapacitetit mbajtës të Tokës* - aktivitetet me qëllim të shmangies së deficitit ekologjik që gjenerohet kur gjurma e popullsisë tejkalon biokapacitetin e zonës që ka në dispozicion kjo popullsi. Për vitin 2023, deficitin ekologjik ka ndodhur më 2 gusht, kur popullsia botërore tashmë kishte tejkaluar burimet vjetore natyrore në botë.
- 6) *Ndryshimi i qëndrimeve dhe praktikave personale* - informacionet duhet të përhapen përmes sistemeve formale dhe joformale të arsimit në mënyrë që të shpjegohen dhe kuptohen politikat dhe aktivitetet e duhura për mbijetesë dhe mirëqenie të shoqërive në botë.
- 7) *Mundësojuni komuniteteve që të kujdesen për mjediset e tyre* - komunitetet e informuara në mënyrë të përshtatshme, me detyra dhe autorizime përkatëse, mund të kontribuojnë me vendimet që kanë impakt te ata dhe të luajnë një rol të pazëvendësueshëm në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe të bazuar në mënyrë të sigurt.
- 8) *Siguroni kornizë kombëtare për integrim dhe ruajtje të zhvillimit* - programi kombëtar për arritjen e qëndrueshmërisë duhet të përfshijë të gjitha interesat dhe të synojë të identifikojë dhe të parandalojë problemet para se të shfaqen.
- 9) *Formoni aleancë globale* - të gjitha kombet do të përfitojnë nga qëndrueshmëria globale - dhe do të cenohen nëse nuk arrihet qëndrueshmëria.

Kur të prezantojë shkolla juaj EZHQ përmes qasjes në nivelin e shkollës, qëllimi përfundimtar duhet të jetë ndryshimi i sjelljes së shoqërisë në lidhje me qëndrueshmërinë, dhe ky është efekti më i dëshirueshëm i shkollës sonë nga pikëpamja e qëndrueshmërisë. Rieckman (UNESCO, 2018.) mendon që ky efekt varet nga ndërveprimi midis njohurive dhe aftësive, vlerave dhe nxitësve të motivimit, si dhe nga mundësitë Ndërlidhja e këtyre dimensioneve ndikon te sjellja personale (Figura 9). Reflektoni gjithashtu dhe listën kontrolluese në aneks për të matur performancën ndaj qëndrueshmërisë në kontekstin që përmendi Rieckman.



Figura 9: Performanca ndaj qëndrueshmërisë sipas Rieckmann-it (UNESCO 2018, fq. 46)

Përfundimi:

Ju përgëzojmë që arritët deri në fund të këtij udhëzuesi! Na vjen mirë që ju mbështetëm dhe që orientuam nismën tuaj për shkollat e gjelbra, bashkëpunimin dhe partneritetet!

Në përfundim, duam të ndajmë me ju disa këshilla se si të përfitoni më shumë nga ky udhëzues:

- Lexojeni udhëzuesin edhe një herë! Po, e kemi seriozisht! Nëse i jeni përkushtuar synimit që të nisni programin e shkollës së gjelbër, atëherë lexojeni udhëzuesin edhe një herë, por me laps dhe fletore, në mënyrë që të bëni referencë për çdo kapitull dhe në mënyrë që shkolla juaj të bëhet reale
- Filloni aty ku ndiheni më të sigurt! Mund të filloni aktivitetin e shkollës së gjelbër nga hapi i 9, nga faqja e 12, faqja 32 ose faqja 5, ose nga lista kontrolluese nga kapitulli i fundit ose nga hapat e përgjithshëm nga kapitulli i parë. Në të vërtetë nuk ka rëndësi sepse të gjitha hapat janë shpërndarë përmes qasjes në nivel shkolle dhe në mënyrë cirkulare dhe jo lineare.
- Na kontaktoni nëse ngecni diku! Do të na vijë mirë t'ju ndihmojmë dhe të zhvillohemi së bashku në formimin e një të ardhmeje të qëndrueshme

Literatür

Aspen Institute Germany, 2022: Green Agenda for the Western Balkans. The Road Toward Effective and Sustainable Implementation. https://www.aspeninstitute.de/wp-content/uploads/Green-Agenda-for-the-Western-Balkans_2023.pdf

Blog - How do you create a culture of environmental responsibility among students? [How do you create a culture of environmental responsibility among students? \(linkedin.com\)](https://www.linkedin.com/company/centerforgreenschools/posts/?feedView=all)

Carnegie Europe: The green transition and the Western Balkans <https://carnegieeurope.eu/2023/10/09/green-transition-and-western-balkans-pub-90730>

Center for green schools (webpage): <https://centerforgreenschools.org/> ; [Green-Schools-Getting-Started-Checklist.pdf \(centerforgreenschools.org\)](https://centerforgreenschools.org/files/2023/09/Green-Schools-Getting-Started-Checklist.pdf)

Eco-mapping, 2002: Handbook. https://kovet.hu/wp-content/uploads/2018/02/GO_Handbook_Ecomapping_2002_version.pdf

Ellen MacArthur Foundation (webpage): Circular Economy <https://www.ellenmacarthurfoundation.org/topics/circular-economy-introduction/overview>

Ellen Mac-Arthur Foundation: Higher Education Resources <https://emf.thirdlight.com/file/24/lwnEDbf15-jkydlwActlw2WylY%5BEN%5D%20Higher%20Education%20Resources.pdf>

ESD Consulting: Embedding Sustainable Development In The Curriculum. Guidance for staff within learning institutions on how to embed sustainability into what and how they teach. https://www.sustainabilityexchange.ac.uk/files/embedding_sustainability_in_the_curriculum_guide.pdf

Environmental Literacy: A lot more than 3Rs: [Environmental Literacy: A Lot More than the 3 Rs | Savvas](https://www.savvas.com/Environmental-Literacy-A-Lot-More-than-the-3-Rs)

European Commission: The European Green Deal - Striving to be the first climate-neutral continent https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal_en

European Commission, 2020: Guidelines for the Implementation of the Green Agenda for the Western Balkans. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020-10/green_agenda_for_the_western_balkans_en.pdf

European Union, 2020: Delivering on the UN's sustainable development goals – A comprehensive approach. https://commission.europa.eu/document/download/06aa3813-0d63-4d8a-b41e-55870596d007_en?filename=delivering_on_uns_sustainable_development_goals_factsheet_en.pdf

Pick it or pick it not" game - It seems I have forgotten the literature for that. It is below:

Environmental center for Development, Education and Networking (EDEN), 2007: "Preke Natyren" (Touch the nature) Handbook

Gamarra A. et.al., 2021: Low-Carbon Economy in Schools: Environmental Footprint and Associated Externalities of Five Schools in Southwestern Europe. [Energies | Free Full-Text | Low-Carbon Economy in Schools: Environmental Footprint and Associated Externalities of Five Schools in Southwestern Europe \(mdpi.com\)](https://www.mdpi.com/1996-1073/14/11/3117)

Gericke N., 2022: Implementation of Education for Sustainable Development Through a Whole School. https://www.researchgate.net/publication/364415468_Implementation_of_Education_for_Sustainable_Development_Through_a_Whole_School_Approach

Green teacher <https://greenteacher.com/teaching-controversial-issues/>

Green Schools Initiative webpage: [Green Schools Initiative : Green Schools](https://www.greenschoolsinitiative.org/)



Guiding principles for Sustainable Development, 2002: https://lutheranworld.org/sites/default/files/dws-guiding_principles_for_sustainable_development_en.pdf

Groundwork East, 2021: ENVIRONMENTAL TOOLKIT FOR SCHOOLS. [Environmental-Toolkit-for-Schools.pdf \(greensuffolk.org\)](#) How to start a green club at your school: [What Is a Green Club and Why Your School Needs One \(weareteachers.com\)](#)

Hollweg, K. S. et. al, 2011: Developing a framework for assessing environmental literacy. Washington, DC: North American Association for Environmental Education. <https://cdn.naaee.org/sites/default/files/inline-files/devframewkassessenvlitonlineed.pdf>

International Institute for Sustainable Development: <https://www.iisd.org/mission-and-goals/sustainable-development>

International case studies of different eco-mapping users worldwide: https://www.belspo.be/belspo/organisation/publ/pub_ostc/nm/nmc01ann_en.pdf

IUCN, 2006: The Future of Sustainability Re-thinking Environment and Development in the Twenty-first Century: <https://portals.iucn.org/library/sites/library/files/documents/Rep-2006-002.pdf>

IUCN, UNEP and WWF, 1991: Caring for the Earth: A Strategy for Sustainable Living. <https://portals.iucn.org/library/efiles/documents/cfe-003.pdf>

Keep Northern Ireland Beautiful (website): [Eco-Schools Northern Ireland \(eco-schoolsni.org\)](#)

North American Association for Environmental Education (NAAEE), 2022: Guidelines for Excellence Environmental Education Programs. [Guidelines for Excellence: Environmental Education Program \(naaee.org\)](#)

Osservatorio balcani e caucaso transeuropa: A long way to go: The Western Balkans and the Green Transition <https://www.balcanicaucaso.org/eng/Areas/Bosnia-Herzegovina/A-long-way-to-go-the-Western-Balkans-and-the-green-transition-225788>

Origins of Environmental Movement: https://michiganintheworld.history.lsa.umich.edu/environmentalism/exhibits/show/main_exhibit/origins

Passion in education: <https://www.passionineducation.com/types-of-education-formal-informal-non-formal/>

Regional Cooperation Council: Green Agenda for the Western Balkans. https://www.rcc.int/priority_areas/61/green-agenda-for-the-western-balkans

Regional Cooperation Council: Green Agenda Western Balkans Action plan: [file:///C:/Users/User/Downloads/Action%20Plan%20ENG%20over%201%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/Action%20Plan%20ENG%20over%201%20(1).pdf)

Severiche-Sierra Jr & Ahumada, 2021: Ecomap or Ecomapping in the productive sector: Practical tool for the diagnosis of the environmental situation. https://www.researchgate.net/publication/352503645_Ecomap_or_Ecomapping_in_the_productive_sector_Practical_tool_for_the_diagnosis_of_the_environmental_situation

Sustainable Development Commission (Archived): <https://www.sd-commission.org.uk/pages/what-is-sustainable-development.html>

The importance of schools in a child life: <https://www.eurokidsindia.com/blog/the-importance-of-school-in-a-childs-life.php>

UNDP Serbia: <https://www.undp.org/serbia/projects/eu-green-agenda-serbia>

UN Transforming Education Summit (webpage): <https://www.un.org/en/transforming-education-summit/transform-the-world>

UNECE Strategy for education for sustainable development, 2005: [Microsoft Word - g0530837.DOC \(unece.org\)](#)

UNESCO: Leading SDG4-Education 2030: <https://www.unesco.org/en/education2030-sdg4/need-know>

UNESCO: ESD for 2030 country initiatives. <https://www.unesco.org/en/education-sustainable-development/country-initiatives#:~:text=Summary&text=Member%20States%20are%20encouraged%20to,could%20have%20country%2Dwide%20impact>.

UNESCO (webpage): Greening every school. Development of the Quality Standard for Green Schools. <https://www.unesco.org/en/education-sustainable-development/greening-future/schools>

UNESCO, 2010: Education for Sustainable Development in Action. Learning & Training Tools no. 2. [Education for sustainable development lens: a policy and practice review tool; Education for sustainable development in action: learning & training tools; Vol.:2; 2013 - 190898eng.pdf \(unesco.org\)](#)

UNESCO, 2012: Education for Sustainable Development, Sourcebook. unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000216383/PDF/216383eng.pdf.multi

UNESCO, 2014: Shaping the Future We Want - UN Decade of Education for Sustainable Development (2005-2014) – Final report. <https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/1682Shaping%20the%20future%20we%20want.pdf>

UNESCO, 2018: UNESCO Global Action Programme on Education for Sustainable development. <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000246270/PDF/246270eng.pdf.multi> ; <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000246270>

UNESCO, 2018: Guidebook on Education for Sustainable Development for educators. Effective teaching and learning in teacher education institutions in Africa. [367474eng.pdf \(unesco.org\)](#)

UNESCO, 2018: Issues and trends in Education for Sustainable Development. <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000261802/PDF/261445eng.pdf.multi.nameddest=261802>

UNESCO. 2019. What is Education for Sustainable Development? <https://en.unesco.org/themes/education-sustainable-development/what-is-esd>

UNESCO, 2020: Education for Sustainable Development: A roadmap. [374802eng.pdf \(unesco.org\)](#)

Usvasalo M. et. al, 2023: The role of education in promoting circular economy. <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/19397038.2023.2210592>

Youth and Environment Europe, 2014: Environmental education for sustainability. [Environmental Education for Sustainability \(yeenet.eu\)](#)

Youth and Environment Europe, 2010: Environmental Management Systems. [EMS EN online.pdf \(yeenet.eu\)](#)

Wals A. & Kieft G., 2010: Education for Sustainable Development Research Overview <https://cdn.sida.se/publications/files/sida61266en-education-for-sustainable-developmentresearch-overview.pdf>

Wei-Ta Fang, 2022: Environmental literacy. [\(PDF\) Environmental Literacy \(researchgate.net\)](#)

We Balkans: <https://webalkans.eu/sr/themes/environment/climate-action/>



Willison J., 2006: Education for Sustainable Development: Guidelines for Action in Botanic Gardens.
https://www.bgci.org/wp/wp-content/uploads/2019/04/education_for_sustainable_development_guidelines_final.pdf

World Commission on Environment and Development, The Brundtland Report, Our Common Future, 1987: <https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/5987our-common-future.pdf>

Aneke 1: Loja “Të vjelësh apo të mos vjelësh”

Qëllimi i lojës: Etika në fushën e mjedisit¹

Grupmosha: Të gjitha moshat

Koha: 15 – 20 minuta

Madhësia e grupit: Jo më shumë se 15 veta

Veçat: Letër, laps



Si të veprojmë?

Pyesni pjesëmarrësit nëse mendojnë se vegjetacioni është i rëndësishëm dhe përse? A dinë disa emërtime të bimëve që përdoren në jetën e përditshme? (Për shembull: Për ushqim, mobilie, objekte, ilaçe, letra, pije etj.)

- Gjeni një hapësirë relativisht të rrafshët dhe kërkoni nga pjesëmarrësit që të shikojnë çdo bimë që u duket interesant dhe i veçantë. Le të ulen pranë bimës.
- Kujdesuni që pjesëmarrësit të mos ulen në grupe. Secili duhet të ketë bimën e vet. Do të ishte e udhës që t’i vendosni në distancë nga njëri-tjetri.
- Për këtë aktivitet do t’ju duhet lapsi dhe letra, kështu që duhet të siguroni këto materiale.
- Kërkoni nga ata që të mendojnë dhe të vendosin nëse duan të vjelin atë lule dhe të shënojnë përgjigjen e tyre.
- Nëse vendosin ta vjelin, vazhdoni me pyetjet e mëposhtme. Kërkoni nga pjesëmarrësit që të shënojnë përgjigjet e tyre në letër.

¹ EDEN center publications: “Touch the nature – didactic materials for organizing environmental education games”. www.eden-al.org



1. A ka mbi 100 bimë të këtij lloji që janë pjesë e kësaj zone?
2. A mund të mësoj diçka më shumë kur e vjel një bimë, a ka diçka që nuk mund të mësoj nëse nuk e vjel atë?
3. A mund të bëj diçka të dobishme nga kjo bimë që do të ndihmojë të tjerët ose mua në një farë mënyre?
4. A do të jetë kaq e bukur bima edhe pasi ta vjel? Nëse po, sa do të mbetet ashtu?
5. A do të jetë e gjallë bima edhe nëse ia vjel vetëm një pjesë?
6. A do të përmirësohet kjo zonë nëse e vjel bimën?
7. A do të mbijetojë bima nëse e vjel?
8. A jam i/e sigurt nëse e vjel?
9. A ka pyetje të tjera të rëndësishme për t'u përgjigjur para se ta vjel bimën?
10. A do të ndikohen vendimet e mia nga fakti që bima rritet në një Park Kombëtar?
11. *Lirisht mund të shtoni pyetje të tjera për rastin tuaj konkret*
12. Çfarë mund të bësh tani? Të vjelësh apo të mos vjelësh? Ajo është pyetja.

Çdo pjesëmarrës ka mjaftueshëm kohë për të shënuar pyetjet dhe vendimet në lidhje me vjeljen e bimës. Kërkoni nga grupi i pjesëmarrësve që të mblidhen në formë rrethi dhe të bisedojnë për këtë çështje; cilat kanë qenë arsyet për të vjelë dhe për të mos vjelë.

Aneksë 2: Formulari i eko-hartës



I Situata urbane II Uji III Toka dhe magazinimi IV Ajri, erërat e pakëndshme, pluhuri dhe zhurma V Energjia VI Mbeturitat VII Risqet dhe siguria

Qëllimi Vlerësimi kryesor Auditim i brendshëm Pasqyra vjetore Pasqyra e zinxhirit të furnizimit

Problemet në lidhje me mjedisin

Ju lutemi të sqaroni problemet në lidhje me mjedisin

Sjellja Pajisjet Procesi Njohuritë dhe aftësitë

Cilësia e të dhënave

- Precize
- Shumë e mirë
- Hamendje

Burim

- Llogaria
- Masa
- Të tjerat...

Faktet dhe të dhënat numerike + Treguesit e mjedisit

Njësitë matëse (kilogramë, litra, m³ etj.)

Korniza kohore dhe qëllimet

A Masat korigjuese dhe parandaluese

B Siguria e punëtorëve

C Masat dhe grumbullimi i të dhënave

D Trajnim dhe edukim

E Menaxhim i mirë i

Plani i veprimit për mjedisin

Përgjegjësia + Kufiri kohor (datë)

Ju lutemi që të filloni me gjërat më urgjente dhe më të rëndësishme dhe



ekonomisë
shtëpiake

F Çështjet juridike

Shpenzimet €

Përfitimet nga masat €

Numër total i masave

Hartoi + nënshkrim..... data

Përditësim i radhës

Ecomapping© Heinz Werner Engel

Aneke 3: Lista kontrolluese për ngritjen e një shoqërie të qëndrueshme.

Lista kontrolluese për ngritjen e shoqërisë së qëndrueshme dhe për rritjen e rolit të shkollave si njësi të pazëvendësueshme të kompetencave nga fusha e mjedisit

KONTRIBUTI NË NGRITJEN E SHOQËRISË SË QËNDRUESHME					
☑ LISTA KONTROLLUESE					
Parimet e qëndrueshmërisë	A ...	☑	☐	☒	Shënime
Respekti dhe përkujdesja për komunitetin	zbaton shkolla aktivitetet e shkarkimit të mbeturinave në mjedis, sidomos në mjedisin që e rrethon?				
	ofron shkolla strehim dhe a kujdeset për format e ndryshme të jetës?				
	ndërton shkolla partneritete me palët e interesuara të orientuara ndaj mjedisit?				
	zhvillohet shkolla si model në të cilin nxënësit dhe komuniteti lokal veprojnë dhe rriten së bashku në mënyrë që të arrijnë objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm?				
	ka shkolla një politikë të gjelbër dhe plan të veprimit?				
	...				
Përmirësimi i cilësisë së jetës	siguron shkolla një ambient të sigurt për nxënësit dhe anëtarët e tjerë të shkollës?				
	siguron shkolla qasje të barabartë në resurse dhe informacione?				
	siguron shkolla lirinë e fjalës dhe a është vend i sigurt?				
	mbështeten nxënësit dhe anëtarët e shkollës që të realizojnë dhe të përmirësojnë potencialin e tyre?				
	zbaton shkolla programet humanitare në terren (ang. Outreach programs) që fokusohen te siguria e shëndetit?				
				
Ruajtja e vitalitetit dhe të shumëllojshmërisë së Tokës	mbron dhe kujdeset shkolla për biodiversitetin natyror në ambientin e saj të jashtëm dhe të brendshëm?				
	zbaton shkolla aktivitetet në të hapur për të kuptuar dhe ruajtur ekosistemet natyrore?				
	ka vendosur shkolla qëllime për uljen e shpenzimit të ujit dhe shkarkimin e mbeturinave?				
	riciklon dhe mbledh ujë shkolla?				
	blen shkolla produkte të favorshme për mjedisin?				
	pranon shkolla qasjen “Mbeturinat Zero”?				
	bën shkolla ndarjen e mbeturinave te vendi i gjenerimit?				
.....					
Minimizimi i shterjes së burimeve të parinovueshme	ka shkolla izolim të përshtatshëm me qëllim të kursimit të energjisë dhe të ngrohjes?				
	përdor shkolla makinat elektrike të efikasitetit të lartë energjetik?				
	investon shkolla në sisteme diellore për energji dhe ngrohje?				
	ka shkolla qëllime të qarta për minimizim të shpenzimit të energjisë?				
	ka shkolla një politikë “pa energji të papastër”?				

	mban shkolla orë të hapura mësimi ku mësohen sjelljet dhe qëndrimet për ruajtjen e energjisë?				
	nxiten sjelljet e orientuara ndaj transportit të qëndrueshëm në shkollë?				
				
Të mbetemi brenda kapacitetit mbajtës të Tokës	zbaton shkolla inspektime për mbrojtjen e mjedisit dhe a vendos objektiva për zvogëlimin e shpenzimit?				
	zbaton shkolla politikën e mospërdorimit të materialeve plastike dhe të atyre njëpërdorimëshe?				
	përfshin shkolla parimet e ekonomisë cirkulare në aktivitetet e saj vjetore?				
	ofron shkolla edukim mbi modelet e zvogëlimit të gjurmës ekologjike?				
	integron dhe prezanton shkolla parimet e zhvillimit të qëndrueshëm në nivelet e saj të punës?				
	trajnon dhe rrit kapacitetet e kuadrove për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm?				
				
Ndryshimi i qëndrimeve dhe praktikave personale	përbën shkolla model për etikën e jetesës së qëndrueshme?				
	zbaton shkolla qasjen e edukimit mbi zhvillimin e qëndrueshëm në nivelin e tërë shkollës?				
	ka shkolla një plan të gjelbër të veprimit dhe qëllimet e gjelbra vjetore?				
	A ka ndonjë anëtar i shkollës që merr pjesë dhe ka mundësi udhëheqëse në Nismën e shkollës së gjelbër?				
	tregon shkolla përparim për sa u përket objektivave të qëndrueshme?				
	ka shkolla qasje të hapur në linja komunikimi dhe informimi?				
				
Mundësia që komunitetet të kujdesen për mjediset e veta	ka shkolla partneritet me komunitetet lokale?				
	përfshin shkolla komunitetin lokal në programin e saj edukativ mbi zhvillimin e qëndrueshëm?				
	organizon shkolla edukime dhe aktivitete ndërgjegjësuëse me dhe për komunitetin lokal?				
	bashkëpunon shkolla me palët e interesuara në fushën e medias dhe të komunikimit?				
				
Sigurimi i kornizës kombëtare për integrimin e zhvillimit dhe të ruajtjes	bashkëpunon shkolla me qeverinë në implementimin e planeve kombëtare të qëndrueshmërisë dhe të ruajtjes së biodiversitetit?				
	ofron shkolla të dhënat dhe informacionet nga terreni për edukimin nga fusha e zhvillimit të qëndrueshëm				
	kontribuon shkolla në nismën shtetërore për edukim në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm për vitin 2030				
				

Formimi i aleancës globale	bën pjesë dhe a kontribuon shkolla në rrjetet e partneritetit të themeluara nga UNESCO për zbatimin e edukimit nga fusha e zhvillimit të qëndrueshëm?				
	integron shkolla objektivat e Agjendës 2030 në politikat e saj?				
				

Parimet janë marrë nga raporti „Kujdesi për tokën“ IUCN, UNEP dhe WWF, 1991: Kujdesi për tokën: Strategjia për jetesë të qëndrueshme (ang. *“Caring for the earth” IUCN, UNEP and, 1991: Caring for the Earth: A Strategy for Sustainable Living*). <https://portals.iucn.org/library/efiles/documents/cfe-003.pdf>

